

Nr. 56/26 Prot.

Tiranë më 09.10.2024

**V E N D I M**

Nr. 46 Datë 09.10.2024

Trupa e Vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

**Suela Bulku**    **Kryesuese**  
**Arben Sefaj**    **Relator**  
**Denisa Sina**    **Anëtare**

Në datën 09.09.2024, në Godinën e Ministrisë së Brendshme, salla e mbledhjeve, kati 1, asistuar nga anëtarja e sekretariatit teknik Znj. Ersila Kalaja, zhvilloi seancën dëgjimore publike për çështjen që i përket:

**SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT:**                    **Z. Niko Axhem Brahimaj**, me funksion Drejtor I Institutit të Policisë Shkencore.

**OBJEKTI:**    Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

**BAZA LIGJORE:**                                    Ligji Nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”.

Rregullore nr.197, datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”.

Trupa e Vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi dëgjoi gjetjet bazuar në arsyetimin ligjor si dhe rekomandimin e relatorit të çështjes z. Arben Sefaj, vlerësoi shpjegimet e subjektit të vlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit, pasi dëgjoi subjektin e vlerësimit Z. Niko Axhem Brahimaj, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikën 1, të nenit 4, të Ligjit Nr.12/2018, i ndryshuar.

## VËREN:

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, shtetasi Z. Niko Brahimaj është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 04.07.2023, *Drejtor i Institutit të Policisë Shkencore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit*.
2. Subjekti i vlerësimit, Z. Niko Brahimaj iu nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar 04.07.2023 nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.7, datë 17.01.2023, “Për procedurat e hedhjes së shortit”.
3. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin Nr. 1 datë 13.07.2023 u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: Znj. Suela Bulku Kryesuese, Z. Arben Sefaj Relator dhe Znj. Denisa Sina Anëtare.
4. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197, datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar” me Vendimin Nr.1 datë 13.07.2023 vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Niko Brahimaj.
5. Relatori i çështjes, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 14.07.2023 ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.
6. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore me e-mailin zyrtar të datë 14.07.2023, me shkresën nr.\*\*\* datë

14.07.2023, duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.

7. Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të Ligjit Nr. 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
8. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
9. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit Nr. 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:
  - Vlerësimin e pasurisë.
  - Kontrollin e figurës.
  - Vlerësimin e aftësive profesionale.
10. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
  - a. Ligji Nr.12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
  - b. Ligji nr.128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”
  - c. Ligji nr. 40/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”
  - d. Ligji nr. 49/2012, “Për gjykatën Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”
  - e. Ligji nr. 9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”
  - f. Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.7, datë 17.01.2023, “Për procedurat e hedhjes së shortit”
  - g. Rregulloren nr.197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”
  - h. Duke verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht deklaratat e dorëzuara nga vetë subjekti i vlerësimit në DPPSH që janë:
    - *Deklarata e Pasurisë,*
    - *Deklarata për Kontrollin e Figurës,*
    - *Formulari i Aftësive Profesionale,*
    - *Dokumentacioni bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklarinimet.*
  - i. Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar.
  - j. Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.
  - k. Ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.
11. Trupa e Vlerësimit, me datë 06.09.2024, pasi dëgjoi relatorin, dhe krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Niko Brahimaj, me Vendimin Nr. 4 datë 06.09.2024, vendosi;

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Niko Brahimaj
  - b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
    - *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht,*
    - *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional.*
  - c. Të ftojë subjektin për t'u njohur me dosjen dhe provat e administruara nga Trupa Vlerësuese, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme prej 5 ditësh për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.
12. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5 i Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funkcioneve Publike”, si dhe nenit 34, pika 1, e Ligjit nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

13. Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit Niko Brahimaj , u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si dhe Kodin e Procedurave Administrative. Subjekti i vlerësimit nuk kishte zgjedhur mbrojtës ligjor. Gjatë seancës dëgjimore, pas fjalës së relatorit, subjekti i vlerësimit parashtroi disa shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e vlerësimit në tërësi të kryer ndaj tij (të regjistruar në materialin audio në seancë dëgjimore). Në fund të seancës dëgjimore datë 09.09.2024, subjekti i vlerësimit Niko Brahimaj kërkoi konfirmimin në detyrë. Trupa e Vlerësimit shpalli vendimin më datën 09.10.2024, për subjektin e vlerësimit.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT**

14. Z. Niko Brahimaj ka qenë korrekt dhe bashkëpunues gjatë procesit të vlerësimit, duke u përgjigjur brenda afatit të përcaktuar, sipas pikës 2, të nenit 48, të ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, të ndryshuar.

## **IV. ARSYETIMI LIGJOR I TRUPËS SË VLERËSIMIT**

### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

15. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, “Vlerësimi i pasurisë”, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
16. Në zbatim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të

Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit Z. Niko Brahimaj ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 03.03.2023. Formulari i Pasurisë ka nr.\*\*\*, index 2023.

18. Procedurat e deklarimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33, ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
19. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridike, publikë apo privatë.
20. Gjithashtu Trupa e Vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklaratimet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së në zbatim të neneve 33/1 dhe 34, shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare. Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.
21. Bazuar në nenin 32, pika 1.1, të ligjit nr. 12/2018 ”Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, “Subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive në rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, nga viti 2008 dhe në vijim”.  
Neni 1 citon; “Subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të deklarojnë çdo pasuri, të luajtshme apo të paluajtshme, të fituar, poseduar, përdorur apo tjetërsuar, nga data e fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë”.

**Trupa e vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:**

- Deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;
- Raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI;
- Provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;
- Dokumentacionin e paraqitur në deklaratimet e subjektit, si edhe përgjigjet e pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike;

**Hetimi administrativ konsistoi në:**

- ✓ Verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ Verifikimin e burimit/eve të krijimit të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- ✓ Evidentimin e ndonjë fshehje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- ✓ Evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

Niko Brahimaj është bërë subjekt deklarues pranë ILDKPKI në vitin 2013, me numër indeksi \*\*\*, dhe sipas deklarimit online me numër indeksi \*\*\*. Në zbatim të ligjit Nr. 9049 datë

10.04.2003 i ndryshuar dhe ligjit nr. 9367 datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave private, dhe përveç këtyre bazuar në ligjin nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar, ka plotësuar edhe deklaratën e pasurisë për vlerësimin kalimtar me datë 17.02.2023.

Ndër vite deklaratat e interesave private, si më poshtë:

- Para fillimit të detyrës 2013
- Periodike/Vjetore 2013
- Periodike/Vjetore 2014
- Periodike/Vjetore 2015
- Periodike/Vjetore 2016
- Periodike/Vjetore 2017
- Periodike/Vjetore 2018
- Periodike/Vjetore 2019
- Periodike/Vjetore 2020
- Periodike/Vjetore 2021
- Periodike/Vjetore 2022
- Deklarata e pasurisë për vlerësimin kalimtar, vetting e Niko Brahimaj, dt. 03.03.2023.

22. Për kryerjen e kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Niko Brahimaj, ILDKPKI ka krahasuar Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe dokumentacionin justifikues bankar, jo bankar, etj., të dorëzuar nga vetë subjekti, deklaratat e interesave private ndër vite, me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës me nr.\*\*\* prot.,

23. Kontrolli i plotë kryhet për periudhën deri në datën e dorëzimit të Deklaratës së Pasurisë, për vlerësimin kalimtar, që përfshin këtë deklaratë dhe deklaratat e interesave privatë.

Bazuar në nenin 32, pika 1.1 të ligjit nr. 12/2018, "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat", i ndryshuar, "Subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive në rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, nga viti 2008 dhe në vijim". Neni 1 citon; "Subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të deklarojnë çdo pasuri, të luajtshme apo të paluajtshme, të fituar, poseduar, përdorur apo tjetërsuar, nga data e fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë".

24. **Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja:** Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 9049, dt. 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, ligjin nr. 9367, dt. 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, në nenin 33/1, të ligjit nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat", i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, bazuar

në dokumentacionin e administruar, ILDKPKI me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 19.01.2024, "Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë për vlerësimin kalimtar të subjektit Niko Brahimaj" protokolluar me tonën nr. \*\*\* prot., datë 24.01.2024 konstatohet se:

- a) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare,
- b) nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë,
- c) nuk është kryer fshehje e pasurisë,
- d) nuk është kryer deklarim i rremë,
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

25. Në zbatim të ligjit nr. 9049, dt. 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, të ligjit nr. 9367, dt. 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat", i ndryshuar në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar është deklaruar:

## **DEKLARIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT- NIKO BRAHIMAJ**

### **DEKLARIMI I PASURUVE**

26. 1. **Apartament banimi me sipërfaqe 94.75 m<sup>2</sup>, me adresë rruga "\*\*\*\*", Nd.\*\*\*, H.\*\*\*, Ap.\*\*\*, Njësia Administrative nr.5, Tiranë.** Blerja e apartamentit sipas kontratës së sipërmarrjes, viti 2001, likuiduar me këste sipas kontratës së sipërmarrjes me datë 21.06.2013. Burimi i krijimit: Kursime familjare ndër vite. Vlera: 41.560 usd. Pjesa takuese: 100%

- ASHK. Drejtoria Vendore Tirana Jug, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.08.2023, konfirmon se në emër të Niko Brahimaj figuron të jetë e regjistruar pasuria me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq.\*\*\*, ZK.8270, e llojit apartament me sip. 94.75 m<sup>2</sup>, përfituar me kontratë shitje marrë nga referenca nr. \*\*\*.

B/lidhur: Kartelë e pasurisë së paluajtshme e llojit apartament me sip. 94.75 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*,fq. \*\*\*, ZK 8270, regjistruar në emër të Niko Brahimaj.

Kontratë shitje pasuri e paluajtshme apartament nr.\*\*\*, datë 21.06.2013, me palë shitëse Gj. H. (në cilësinë e investitorit në ndërtim) dhe palë blerëse Niko Brahimaj, të apartamentit me sip. 94.75 m<sup>2</sup>, e regjistruar me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, ZK. 8270, në shumën 41.560 Usd. Kjo pagesë është shlyer me këste sipas kontratës së sipërmarrjes të vitit 2001 dhe palët nuk kanë detyrim ndaj njëri-tjetrit. Certifikatë + kartelë e pasurisë së paluajtshme në emër të shitësit. Akt Kolaudimi Tekniko - Ekonomik të objektit nr. 3, banim + shërbime, 11 Kate + Papafingo në v. 2008. Praktika.

- Union Bank, me shkresën nr. \*\*\* prot., dt. 31.07.2023, konfirmon se Sadete Rringaj ka pasur llogari bankare me balancë në dt. 03.03.2023, në vlerën 0 lekë. B/lidhur amortizim kredie bankare, ku në datën 29.08.2014, është disbursuar kredia bankare, në shumën 179.965 lekë, me afat 1- vjeçar.
- Në proces verbalin e datës 30.11.2023 subjekti u pyet në lidhje me burimin financiar, sipas kontratës së sipërmarrjes, dhe të paraqes dokumentacion justifikues ligjor.
- Në inventarin e datës 20.12.2023 subjekti paraqiti shpjegime:

27. Subjekti sqaroi se apartamenti është prenotuar në vitin 2001, kur pallati ka qenë në ndërtim. Ndërtimi ka përfunduar në 2003-2004 dhe kolaudimi është bërë në vitin 2008. Certifikimi i pronës është bërë në vitin 2013, nga ana e pronarit dhe më pas është lidhur kontrata përfundimtare, ku subjekti ka marrë certifikatë pronësie. Pagesat për blerjen e pasurisë janë bërë me këste, duke filluar nga vitin 2001 deri në vitin 2013, sipas mundësive financiare. Kësti i fundit është kryer me nënshkrimin e kontratës përfundimtare, para përfitimit të dokumentit të pronësisë viti 2013. Në këtë apartament subjekti ka banuar nga viti 2003 (pas martesë). Nuk e përcakton dot sa kanë qenë shumat e kësteve, kohën e pagesave, pasi ka kaluar shumë kohë, dhe nuk disponon kontratë sipërmarrje dhe mandat pagesash. Në lidhje me burimin financiar që ka shërbyer për likuidimet e kësteve janë nga kursimet e tij dhe të b/shortes, të ardhura këto të kursyera ndër vite nga punësimet e tyre.

### **HETIMI I KRYER NGA TRUPA VLERËSUESE PRANË AMP**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjen e subjektit rezulton se në vitin 2001 subjekti i vlerësimi me një kontratë sipërmarrje ka pronotuar një apartament banimi me sipërfaqe 94.75 m<sup>2</sup>, me adresë rruga "\*\*\*\*", Nd.\*\*\*, H.\*\*\*, Ap.\*\*\*, Njësia Administrative nr.5, Tiranë. Në momentin e pronotimit pallati ka qenë në ndërtim. Vlera e shitjes së apartamentit sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\* rep., dhe nr.\*\*\* kol., datë 21.06.2013 është 41.560 USD. Ndërtimi ka përfunduar rreth vitit 2003-2004 dhe kolaudimi është bërë në vitin 2008. Shuma është likuiduar me këste. Për mënyrën e likuidimit afatet kohore dhe dokumentacionin që disponon është pyetur subjekti dhe në kthim përgjigjen e tij sqaron se:

Pagesat për blerjen e pasurisë janë bërë me këste duke filluar nga viti 2001 e që ka vazhduar deri me 2013, sipas mundësive financiare që ka patur, kësti i fundit është paguar me nënshkrimin e kontratës përfundimtare. Kontratën e sipërmarrjes nuk e disponon gjithashtu nuk disponon as edhe mandat pagesat apo faturat financiare për likuidimin e apartamentit. Gjithashtu subjekti nuk ka mundur që të gjejë kontakte me shoqërinë zbatuese të ndërtimit.

28. Në lidhje me mobilimin, subjekti sqaron se kuzhina (mobilie, furra e gatimit dhe frigorifer), tavolina e ngrënies, 2 divane, mbajtëse TV, tavolinë mesi, dhomë gjumi janë blerë rreth vitit 2003 - 2004, me sa i kujtohen, janë përafërsisht në vlerën 200.000 lekë, të blera sipas mundësive financiare. Duke qenë se ka kaluar shumë kohë, nuk disponon as një faturë për blerjen e tyre. Burimi financiar, janë kursime nga të ardhurat e pagës së tij dhe b/shortes.

Në vitin 2014, bashkëshortja ka blerë disa pajisje në "\*\*\*\*" me një kredi konsumatore marrë në Union Bank në vlerën rreth 180.000 lekë. Vitet e fundit 2020 - 2021 kanë blerë pajisje elektroshtëpiake konkretisht një televizor, lavatriçe dhe një kondicioner përafërsisht në vlerën 70.000 lekë vitin e parë dhe 80.000 lekë vitin e dytë, me burim të ardhurat nga pagat. Nuk disponon faturë për të konfirmuar blerjen e tyre. Subjekti rideklaron se ai dhe b/shortja, nuk disponojnë asnjë faturë financiare për likuidimin e apartamentit. Subjekti është interesuar për të gjetur dokumentacion të mëtejshëm pranë shoqërisë së ndërtimit dhe nuk ka gjetur kontakte. Paraqiti:

- ✓ Kontratë shitje pasuri e paluajtshme apartament nr. \*\*\* datë 21.06.2013, me palë shitëse Gj. H (në cilësinë e investitorit në ndërtim) dhe palë blerëse Niko Brahimaj të apartamentit me sip. 94.75 m<sup>2</sup>, e regjistruar me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, ZK. 8270, në shumën 41.560 Usd, me adresë Rruga "\*\*\*\*", Tiranë. Kjo pagesë është shlyer me këste sipas kontratës së sipërmarrjes të vitit 2001 dhe palët nuk kanë detyrim ndaj njëri tjetrit.



- ✓ Certifikatë për vërtetim pronësie në emër të Gj. H., të apartamentit me sip. 94.75 m<sup>2</sup>, në datë 10.05.2013. Kartela e pasurisë së paluajtshme + harta treguese.
- ✓ Akt Kolaudimi Tekniko - Ekonomik të objektit nr. \*\*\*, banim + shërbime 11 Kate + Papafingo në viti 2008, me investitor Gj. H. Kopje e id-ve.
- ✓ Certifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 27.06.2013, në emër të Niko Brahimaj, të apartamentit me sip. 94.75 m<sup>2</sup>, në ZK. 8270, vol. \*\*\*, fq.\*\*\*, në adresën rr. "\*\*\*\*" hyrja nr.\*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë. Kopje e Id-ve.
- ✓ Me postën elektronike të datës 17.01.2024, subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me banimin gjatë periudhës 1987 - 2003.
  - Bazuar në deklarin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:
    - Apartamenti me sip. 94.75 m<sup>2</sup> me adresë rruga "\*\*\*\*", në Tiranë është përfituar me kontratë shitje në vitin 2013, në vlerën 41.560 USD, shlyer me këste sipas kontratës së sipërmarrjes të vitit 2001, me burim nga kursimet familjare.
- ✓ Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues lidhur me blerjen dhe regjistrimin e apartamentit në Tiranë në vitin 2013, e konfirmuar nga ASHK.
- ✓ Ka deklaruar shpenzime për mobilimin e apartamentit ndër vite në shumën rreth 530.000 lekë.
  - Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur, shpjegimet e dhëna me përgjigjen e ardhur nga ASHK.

**29. 2. Blerje automjeti Land Rover tip LTG Discovery nr. shasie SALLTGM 842A760\*\*\*, me targa TR\*\*\*N, blerë me kontratë nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë 02.06.2008, në shumën 500.000 lekë.** Burimi i krijimit: Kursime personale, familjare ndër vite. Pjesa takuese: 100%. DPSHTRR me shkresën nr. \*\*\* prot., dt. 10.08.2023, konfirmon se Niko Brahimaj ka pasur të regjistruar mjetin me targa TR\*\*\*P. B/lidhur dosje e mjetit, me targa TR\*\*\*P (TR\*\*\*N).

30. Bashkëlidhur dokumentacioni:

- Kontratë shitblerje automjeti nr. \*\*\*, datë 02.06.2008, me palë shitëse L.Rr. dhe palë blerëse Niko Brahimaj, të mjetit tip Land Rover tip Discovery me targa TR\*\*\*N, nr. shasie SALLTGM842A760\*\*\*, në shumën 500.000 lekë. Praktika.
- Kontratë shitblerje automjeti nr. \*\*\*, datë 12.05.2016, me palë shitëse Niko Brahimaj dhe palë blerëse E.M., të mjetit tip Lind Rever tip Discovery me targa TR\*\*\*P, nr. shasie SALLTGM842A760\*\*\*, në shumën 6.000 euro.
- Në proces verbalin e datës 30.11.2023 subjekti u pyet në lidhje me vlerën e blerjes së mjetit në shumën 500.000 lekë, në v. 2008 dhe vlerën e shitjes në v. 2016, në shumën 6.000 euro.
- Në inventarin e datës 20.12.2023 subjekti paraqiti shpjegime, ku për mjetin e blerë në v. 2008, sqaroi se e ka përdorur dhe mbajtur në gjendje të mirë duke i kryer dhe shërbimet e nevojshme. Në momentin që doli një rast i favorshëm për shitje e realizoi atë. Burimi financiar janë kursimet e përbashkëta familjare.
- Kontratë shitblerje automjeti, nr. \*\*\*, datë 12.05.2016, me palë shitëse Niko Brahimaj dhe palë blerëse E.M. të mjetit tip Land Rover Discoveyy, nr. shasie SALLTGM 842A760\*\*\*, me targa TR\*\*\*P, në shumën 6.000 euro.

- Leje qarkullimit të mjetit me targa TR\*\*\*P. Vërtetim nr. \*\*\*, datë 06.05.2016, nga DPSHTRR që vërteton se Niko Brahimaj është pronar i mjetit me targa TR\*\*\*P. Kopje e ID-ve.

31. Në lidhje me vlerën e blerjes së mjetit në shumën 500.000 lekë, në v. 2008 dhe vlerën e shitjes në v. 2016, në shumën 6.000 euro, ku 1 euro me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në majë 2016 ishte 138.32 lekë, rezulton se mjete është shitur në vlerën 829.920 lekë. Diferenca është + 329.920 lekë. Për diferencën prej 329.920 lekë subjekti i vlerësimit me e-mailin e datës 19.04.2024 u pyet nëse është paguar Tatim Fitimi?.

Subjekti në kthim përgjigjen e tij me e-mailin e datës 23.04.2024, sqaron se: *Në lidhje me pyetjen nuk kam patur dijeni dhe nuk më është bërë e ditur nga noteri.*

**Konkluzion i Trupës Vlerësuese:**

- ✓ *Konstatohet se automjeti me targa TR\*\*\*P është blerë në vitin 2008 në shumën 500.000 lekë, me kursime familjare ndër vite, dhe është shitur në vitin 2016 në shumën 6.000 euro.*
- ✓ *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.*
- ✓ *Trupa Vlerësuese pranë AMP vlerëson se, meqenëse për diferencën prej + 329.920 lekë, nuk është paguar tatimi mbi fitimin, në tabelën e analizës financiare, merret në konsideratë dhe konsiderohet e ligjshme, vetëm shuma prej 500.000 lekë. (çmimi fillestar i blerjes së mjetit).*

32. 3. **Blerje automjeti Land Rover Discovery 3, viti i prodhimit 2008 (traga WFB\*\*\*) blerë me kontratë shitblerje automjeti nr. \*\*\* rep. nr. \*\*\* kol. datë 12.05.2016.**

Burimi i krijimit: Burime nga të ardhurat personale. Diferenca prej 70.000 lekë kursime familjare. Vlera: 900.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.


Bashkëlidhur dokumentacioni:

- Kontratë shitblerje automjeti nr. \*\*\* datë 12.05.2016, me palë shitëse E.R. dhe palë blerëse Niko Brahimaj të mjetit tip Land Rover Discovery 3, nr. shasje SALLAAA648A477\*\*\*, me targa WFB\*\*\*, në shumën 950.000 lekë. Praktika. Deklaratë doganore.

- Kontratë shitblerje automjeti nr. \*\*\*, datë 20.05.2020, me palë shitëse Niko Brahimaj dhe palë blerëse G.I, të mjetit tip Land Rover Discovery 3, nr. shasje SALLAAA648A477\*\*\*, me targa AA\*\*\*ON, në shumën 6.500 euro.

Në proces verbalin e datës 30.11.2023, subjekti u pyet në lidhje me deklarinimin e vlerës së blerjes së mjetit dhe burimi financiar.

Në inventarin e datës 20.12.2023 paraqiti shpjegime, ku subjekti sqaroi se ka qenë një lapsus deklarimi i vlerës së blerjes së mjetit, pasi referuar kontratës së shitjes vlera është 950.000 lekë. Deklaroi se burimi financiar është nga kursimet nga pagat, dhe shitja e mjetit të mëparshëm.

 DPSHTRR me shkresën nr. \*\*\* prot., dt. 10.08.2023, konfirmon se Niko Brahimaj ka pasur të regjistruar mjetin me targa AA\*\*\*ON. B/lidhur dosje e mjetit, me traga AA\*\*\*ON.

Kontratë shitblerje automjeti nr. \*\*\*, datë 12.05.2016, me palë shitëse E.R. dhe palë blerëse Niko Brahimaj, të mjetit tip Land Rover Discovery 3, nr. shasje SALLAAA648A477\*\*\*, me targa WFB\*\*\*, në shumën 950.000 lekë. Deklaratë doganore. Leje qarkullimi. Certifikatë pronësie. Kopje e ID-ve. Praktika e mjetit.

Kontratë shitblerje automjeti nr. \*\*\*, datë 20.05.2020, me palë shitëse Niko Brahimaj dhe palë blerëse G.I, të mjetit tip Land Rover Discovery 3, nr. shasje SALLAAA648A477\*\*\*, me targa AA\*\*\*ON, në shumën 6.500 euro. Kopje të ID-ve + praktika.

**Trupa Vlerësuese Vlerëson se:**

- ✓ *Konstatohet se automjeti me targa AA\*\*\*ON, është blerë në v. 2016, në shumën 950.000 lekë, deklaruar në shumën 900.000 lekë dhe shitur në v. 2020, në shumën 6.500 euro, ose 801.000 lekë, me burim nga shitja e automjetit të mëparshëm dhe kursimet nga pagat.*
- ✓ *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.*

**33. DEKLARIMI TË ARDHURAVE**

- Të ardhura nga punësimi Inspektor SHIK-Tiranë, për periudhën korrik 1991 deri në dhjetor 1992, vlera 148.200 lekë.
- Dhjetor 1992 deri me 1997 i papunë. Vlera 0 lekë.
- Të ardhura nga paga për periudhën e punësimeve qershor 1997 deri mars 2006, në funksione të ndryshme të Policisë së Shtetit. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit Gramsh, Pogradec, Lushnjë, Dibër, MRP, Elbasan, Tiranë, Has.
- Shuma totale për gjithë periudhën 5.780.000 lekë.
- Mars 2006 deri maj 2007 i papunë.
- Maj 2007 - nëntor 2009 punësuar Menaxher Burimeve Njerëzore pranë kompanisë "\*\*\*\*" ShPK., NUIS: K51827\*\*\*A, me pagë mujore neto 58.000 lekë.
- Në nëntor 2009 - tetor 2013 i papunë.
- Të ardhura nga paga për periudhën e punësimeve në funksione të ndryshme të Policisë së Shtetit: tetor 2013 - dhjetor 2014, DPQ Lezhë; dhjetor 2014 - mars 2017 pranë DPPSH Drejtor FLO; mars 2017 - prill 2018 DPPSH Drejtor i Hetimit të Krimeve të Rënda. Shuma në total për periudhën 7.337.488 lekë.
- Të ardhura nga paga bruto për periudhën e punësimeve në funksione të ndryshme të Policisë së Shtetit: prill 2018 - mars 2019, DPPSH, Drejtor në Drejtorinë Kundër Krimeve ndaj Personit dhe Pasurisë në Departamentin e Policisë Kriminale, 2.018.294 lekë. Mars 2019 - korrik 2021, DVP Shkodër, Drejtor në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër, 4.135.578 lekë. Shuma në total për periudhën 6.153.872 lekë, të ardhura nga paga për periudhën e punësimit korrik 2021 - 2022 - maj 2023, Drejtor i Institutit të Policisë Shkencore:
  - 2021 -Total paga neto + ushqim + shpërblime në shumën 1.345.753 lekë;
  - 2022 -Total paga neto në shumën 1.344.418 lekë;
  - Janar - Maj 2023 - Total paga bruto në shumën 960.393 lekë.
- Shuma në totale për periudhën 3.650.564 lekë.
- Shitje automjeti Land Rover tip LTG Discovery, viti i prodhimit 2002, nr. shasië SALLTGM 842A760\*\*\*, me targë TR\*\*\*P, shitur me kontratë shitblerje automjeti nr. \*\*\* rep. , nr.\*\*\* kol., datë 12.05.2016, në shumën 6.000 euro.
- Shitje automjeti tip Land Rover Discovery 3, viti i prodhimit 2008, me traga AA\*\*\*ON, shitur me kontratë shitblerje automjeti nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë 20.05.2020, në shumën 6.500 euro.

✚ Raiffeisen Bank, me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 27.07.2023, ka b/lidhur nxjerrje llogarie bankare të Niko Brahimaj, ku janë kredituar të ardhurat nga pagat, shpërblime, honorarë, telefoni dhe veshje, për periudhën janar 2006, 05.02.2008 - 02.07.2009 dhe nga data 01.11.2013 - 03.03.2023, në vlerën 13.497.434 lekë. Gjithashtu më datë 27.05.2020, është kredituar vlera 801.000 lekë, me përshkrimin G.N.I., pagesë blerje makine sipas kontratës nr. \*\*\* , dt. 20.05.2020 me targë AA\*\*\*ON.

- ✚ ISSH me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 07.08.2023, konfirmon se Niko Brahimaj ka përfitur të ardhura nga punësimi pranë punëdhënësve: Drejtoria e Policisë së Qarkut Lezhë, DPP Drejtoria e Forcës së Posaçme Operacionale, Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkodër, Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër; Instituti i Policisë Shkencore, për periudhën tetor 2013 - qershor 2023.
  - ✚ Drejtoria e Arkivit Qendror, me shkresën me nr. V-Prot, datë 09.08.2023, përcjell informacion për shtetasin Niko Brahimaj, ku figurojnë të dhëna që ka qenë në marrëdhënie pune gjatë periudhës 24.05.1978 - 30.12.1983, si dhe funksionet e kryera nga ai.
34. Në proces verbalin e datës 30.11.2023, subjekti u pyet në lidhje me pagesën nga shoqëria "\*\*\*\*" ShPK dhe dokumentacion për punësimin e tij.
- Në inventarin e datës 20.12.2023 paraqiti shpjegime:
- Në lidhje me punësimet e subjektit ndër vite dhe të ardhurat financiare, subjekti ka b/lidhur dokumente mbi të ardhurat për periudhën e punësimeve 1991 - 2005.
- Ka deklaruar me përafërsi të ardhurat e tij, që mund të mbartin edhe lapsus në mbledhjen e tyre. Ka deklaruar paga bruto është ngatërruar me pagën neto. Bashkëlidhur dokumentacioni:
- ✓ Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 28.08.2020, nga SHISH, që konfirmon se Niko Brahimaj ka qenë i punësuar për periudhën nga data 01.09.1991 - 01.12.1992, dhe ka përfitur të ardhura në shumën 37.017 lekë. Evidentohet se trajtimi financiar ka filluar me datë 15.12.1991, për Niko Brahimaj.
  - ✓ Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 02.04.2021, nga Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, që konfirmon se Niko Brahimaj, ka qenë i punësuar nga data 01.10.1997 - 16.01.1998, dhe ka përfitur të ardhura nga paga neto në shumën 38.262 lekë.
  - ✓ Vërtetim nr.\*\*\* prot., datë 06.04.2021, nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier, që konfirmon se Niko Brahimaj ka përfitur të ardhura për periudhën 16.01.1998 deri në 04.08.1998, në shumën 99.339 lekë.
  - ✓ Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare nga Drejtoria e Policisë Dibër, në emër të Niko Brahimaj, i cili ka realizuar të ardhura nga paga + taksë solidariteti, për periudhën 04.08.1998 - 22.06.1999, në shumën 343.335 lekë.
  - ✓ Vërtetim nr.\*\*\* prot., datë 09.04.2021, nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, që konfirmon se Niko Brahimaj ka përfitur të ardhura nga paga, shpërblime, dieta, orë suplementare, për periudhën 10.12.2003 - 16.11.2005, në shumën 1.570.881 lekë.
  - ✓ Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 08.04.2021, nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, që konfirmon se Niko Brahimaj ka qenë i punësuar për periudhën nga data 01.06.1997 - 01.10.1997, dhe nga data 01.04.2002 - 22.04.2003 ka përfitur të ardhurat nga pagat + taksë solidariteti, shpërblime etj., në shumën 794.231 lekë.
  - ✓ Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 10.05.2021, nga Drejtoria e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar, që konfirmon se Niko Brahimaj, ka përfitur të ardhura nga paga neto për periudhën 23.06.1999 - 21.06.2001, në shumën 1.097.468 lekë. Nuk ka të dhëna në lidhje me shpërblimet dhe taksën e solidaritetit.
  - ✓ Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare dt. 24.08.2020, nga DPPSH, që konfirmon se Niko Brahimaj, ka realizuar të ardhura nga pagat për periudhat 01.07.2001 - 21.03.2002 dhe 15.09.2003 - 19.12.2003, në shumën 810.252 lekë.
  - ✓ Vërtetim datë 11.01.2021, nga shoqëria "\*\*\*\*" që konfirmon se shtetasi Niko Brahimaj ka qenë i punësuar pranë kësaj kompanie, në pozicionin e menaxherit të burimeve njerëzore, nga maj 2007 - nëntor 2009, ka marrë pagë neto në muaj në vlerën 58.000 lekë (Ilogaritur 1.740.000 lekë).

- ✓ Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare nr. \*\*\* prot., datë 12.10.2022, nga DPPSH, në emër të Niko Brahimaj, i cili ka realizuar të ardhura nga pagat dhe shpërblimet, për periudhën 08.07.2021 - 31.12.2021.
  - ✓ Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, nga DVP Shkodër, në emër të Niko Brahimaj, i cili ka realizuar të ardhura nga pagat dhe shpërblimet për periudhën 01.01.2021 - 08.07.2021.
  - ✓ Ekstrakt historik nga DPT, në lidhje me punësimin e Niko Brahimaj në DPPSH, nga dhjetor 2014 - nëntor 2020.
  - ✓ Kontratë shitblerje automjeti nr.\*\*\*, datë 12.05.2016, me palë shitëse Niko Brahimaj dhe palë blerëse E.M., të mjetit tip Land Rover Discovery nr. shasia SALLTGM842A760\*\*\*, me targa TR\*\*\*P, në shumën 6.000 euro.
  - ✓ Kontratë shitblerje automjeti nr. \*\*\*, datë 20.05.2020, me palë shitëse Niko Brahimaj dhe palë blerëse G.I, të mjetit tip Land Rover Discovery 3, nr. shasia SALLAAA648A477\*\*\*, me targa AA\*\*\*ON, në shumën 6.500 euro.
  - Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor në lidhje me të ardhurat e deklaruara.
  - Të ardhurat e subjektit nga paga, shpërblimet, honorarët, taksë solidaritetit etj., për periudhën shtator 1991 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 20.028.000 lekë.
35. Në lidhje me punësimin e tij në “\*\*\*\*” ShPK., subjekti sqaroi se është paguar cash. Theksoi se për këtë periudhë punësimi 2007 - 2009, të ardhurat kanë qenë në shumën rreth 1.750.000 lekë. Subjekti paraqiti vërtetim nga shoqëria “\*\*\*\*” ShPK datë 01.01.2021 ku administratori i saj z. I.P. vërtetoi se z. Niko Brahimaj, ka qenë i punësuar pranë kësaj kompanie, në pozicionin e Menaxherit të Burimeve Njerëzore nga Maji 2007 deri më Nëntor 2009. Paga e tij mujore ka qenë 58.000 leke në muaj. Subjekti ka deklaruar se është paguar cash dhe jashtë sistemit bankar.
36. Në lidhje me këtë konstatim, Trupa Vlerësuese pranë AMP, ju drejtua subjektit të vlerësimit me pyetjen se: Në vitin 2007 - 2009 ju keni deklaruar se keni qenë në marrëdhënie punësimi në kompaninë “\*\*\*\*” ShPK dhe keni realizuar të ardhura nga punësimi në masën 1.700.000 lekë. A dispononi dokumentacion për këtë marrëdhënie punësimi me këtë kompani?. A janë derdhur kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si edhe Tatim mbi të ardhurat personale?. Pagat a kanë kaluar nëpërmjet sistemit bankar?.  
Në kthim përgjigjen me email të datës 23.04.2024 subjekti sqaroi se: *Në lidhje me pyetjen, shpjegimet i kam dhënë shteruese në deklaratën e pasurisë, nuk kam gjë për të shtuar.*
37. Në bazë të Ligjit Nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në R.SH.” i ndryshuar, si edhe në ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 për “Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, për pagën bazë mujore në masën 58.000 lekë të deklaruar nga subjekti për periudhën nga maji 2007 deri më nëntor 2009 duhej të ishin derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si edhe tatimi mbi të ardhurat personale. Shuma duhej të kishte kaluar nëpërmjet sistemit bankar dhe e shoqëruar me dokumentacion.
38. Nisur nga faktet e mësipërme Trupa Vlerësuese argumenton se të ardhurat e përfituara nga punësimi si menaxher i Burimeve Njerëzore në Kompaninë “\*\*\*\*” ShPK, shuma prej 1.750.000 lekë e përfituar, pa dokumentacion, që të konsiderohet e ligjshme dhe që të përfshihej në analizën financiare të subjektit duhej të ishte justifikuar me dokumentacion dhe për të, të ishte

dredhur kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si edhe tatimi mbi të ardhurat personale.

### **Konkluzioni i Trupës vlerësuese:**

- ✓ *Nisur nga ky konstatim Trupa Vlerësuese, vlerëson se shumën prej 1.750.000 lekë nuk e konsideron të ardhur të ligjshme, dhe si të tillë nuk e përfshin në tabelën e rezultatit financiar.*

### **SHPENZIMET E DEKLARUESHME**

39. Të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur. - Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022.

- ✓ Shpenzimet e vitit të fundit 2022 konsum ujë, energji, telefon, internet;
- ✓ Shpenzime për konsum ujë; Kontratë nr. 102\*\*\*-1. Vlera 22.800 lekë.
- ✓ Shpenzime për konsum energjie; Kontratë nr. TRI 0030221145\*\*\*. Vlera 60.000 lekë.
- ✓ Shpenzime për telefon shërbim interneti dhe IPTV; Kontaktuar me Albtelekom. Vlera 27.400 lekë.
- ✓ Shpenzime për telefon mobile 06920\*\*\* (subjekti). Vlera 28.800 lekë.
- ✓ Shpenzime për telefon mobile 06740\*\*\* (person i lidhur). Vlera 18.000 lekë.
- ✚ FSHU me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 04.08.2023, konfirmon se në emër të Niko Brahimaj rezulton të jetë lidhur një kontratë për shërbimin e furnizimit me energji elektrike nr. TR10030221145\*\*\*, në instancën Tiranë. Institucioni nuk disponon kontrata të lidhura para viti 2007, pasi menaxhohej nga KESH. Ka b/lidhur informacion për klientin Niko Brahimaj, me kontratë me nr. TR10030221145\*\*\*, adresa "\*\*\*\*". Pagesat për periudhën 18.02.2023 - 25.01.2023, janë në vlerën rreth 67.841 lekë.
- ✚ 15 Shoqëria Rajonale Ujësjellës - Kanalizime sha, nuk konfirmojnë kontrata të regjistruara në emër të Niko Brahimaj dhe personave të lidhur me të.
- ✚ Vodafone, me shkresën nr. \*\*\* prot., dt. 03.11.2023, ka përcjellë informacion, ku konfirmohet se në emër të shtetasit Niko Axhem Brahimaj korrespondojnë numrat celulare; 3556941\*\*\* të regjistruar në datë 05.12.2016 dhe 3556920\*\*\*, të regjistruar në datë 20.07.2015. Totali i pagesave për numrin 06941\*\*\*, gjatë vitit 2022 është në vlerën 28.818 lekë. Totali i pagesave për numrin 06920\*\*\*, gjatë vitit 2022, është në vlerën rreth 30.000 lekë. B/lidhur praktika.
- ✚ One Albania sha me shkresën nr. \*\*\* prot., dt. 26.09.2023, konfirmon se në emër të Sadete Rringaj, rezulton i regjistruar numri fiks 355423\*\*\*. Totali i pagesave gjatë vitit 2022, është në vlerën 26.413 lekë. Praktika.
- ✚ Albania Satelitë Communications sh.p.k, me shkresën nr. \*\*\* prot, dt. 14.08.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- ✚ Abissnet sha me shkresën nr. V- Prot, dt. 04.08.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- ✚ Digicom sha, me shkresën nr. \*\*\* prot., dt. 09.08.2023, nuk konfirmon kontrata për internetin të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- ✚ Credins Bank me shkresën nr. \*\*\* prot., dt. 16.10.2023, ka b/lidhur nxjerrje llogari bankare të Sadete Rringaj, ku gjatë periudhës 01.01.2022 - 30.10.2022, konfirmohen pagesat për UKT, FSHU, dhe për Albtelekom.

- ✓ Në proces verbalin e datës 30.11.2023: subjektit iu kërkua dokumentacion lidhur me shpenzimet për ujë, si dhe shpjegime në lidhje me konstatimin e institucioneve të mësipërme.
- ✓ Në inventarin e datës 20.12.2023 subjekti paraqiti shpjegime ku ka sqaruar:  
Kontrata me UKT është në emër të tij dhe pagesat kryhen nga llogaria bankare e b/shortes, pranë Credins Bank. Ka deklaruar me përafërsi fatura mujore rreth 1.900 lekë. Gjithashtu edhe shpenzimet për energji elektrike paguhen kryesisht nga llogaria e b/shortes online në Credins Bank, ku janë përlloritur fatura mujore rreth 5.000 lekë.  
Në lidhje me shpenzimet për telefoninë subjekti sqaroi se ka deklaruar numrin personal të tij dhe të b/shortes të konfirmuar nga institucionet, dhe se ka deklaruar me përafërsi këto shpenzime. Në lidhje me konstatimin për numrin 3556941\*\*\*, në emrin e subjektit shpenzimet kryhen nga institucioni dhe nuk e ka deklaruar si shpenzim. Shpenzimet për telefon mobile (Sadete Rringaj), 06740\*\*\*, janë në shumën rreth 1.500 lekë/në muaj, shpenzime të cilat paguhen kryesisht nga llogaria e b/shortes online. Lidhur me kontratën me Albtelekom për shërbim internet dhe IPTV për vitin 2022, konfirmon pagesën sipas "One Albania" Subjekti konfirmon shpenzimet sipas institucioneve përkatëse.

#### 40. Dokumentacioni shoqërues:

- ✓ Kontratë nga Ujësjetllës Kanalizime sha. me nr. 102\*\*\*, në emër të Niko Brahimaj.
- ✓ Dokument i klientit Niko Brahimaj me OSHEE, me nr. 145\*\*\*, për furnizim me energji elektrike për përdorim familjar, në adresën "\*\*\*\*", Tiranë.
- ✓ Kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., dt. 30.12.2019, nga OSHEE, drejtuar KJV-së, që konfirmon se Niko Brahimaj rezulton të ketë lidhur një kontratë për shërbimin e furnizimit me energji elektrike nr. TR10030221145\*\*\*, në instancën Tiranë.
- ✓ Kontratë shërbimi IPTV me Albtelekom dhe Sadete Rringaj, për shërbimin IPTV, sipas kushteve të kontratës. Aneks 5, proces-verbal i marrjes në dorëzim i pajisjeve nga pajtimtari në dt. 25.12.2015 + praktika.
- ✓ Nxjerrje llogari bankare në Credins Bank në emër të Sadete Rringaj, ku gjatë periudhës 01.01.2022, deri në datë 30.10.2022, konfirmohen pagesat për UKT, FSHU, Albtelekom.
- ✓ Shpenzimet e deklaruara për ujë + drita + telefoni + internet gjatë periudhës 01.01.2022 - 31.12.2022, rezultojnë në total rreth 176.000 lekë.
- ✓ Për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara.- Periudha 01.01.2020 - 31.12.2022.
- ✓ Shpenzimet për udhëtime për tre vitet e fundit 2020-2021-2022.
- ✓ Udhëtime në v. 2020 nuk ka.
- ✓ Udhëtime viti 2021, dalje datë 08.09.2021 - hyrje 20.09.2021. Stamboll qëllimi pushime, Akomodimi në Hotel (me bashkëshorten person i lidhur). Vlera 1.300 euro.
- ✓ Udhëtime 2022, dalje datë 17.07.2022 - 21.07.2022, Gjermani - Berlin, shërbim pune, akomodimi me fondet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Vlera 0 lekë. Udhëtim dalje datë 03.09.2022, Durrës - Bari, me automjet me targë AA\*\*\*NM hyrja 11.09.2022, destinacioni Itali, akomodimi në Hotel, qëllimi privat, shpenzime personale (me bashkëshorten person i lidhur). Vlera 3.000 euro.

#### 41. **Personi i lidhur bashkëshortja:**

Udhëtime viti 2020 nuk ka.



Udhëtime viti 2021:

- ✓ Dalje datë 15.03.2021 Morinë - Kosovë, me autoveturë targa AA\*\*\*MF. Hyrje datë 16.03.2021, Morinë Shqipëri me autoveturë targa AA\*\*\*MF. Arsyjeja private akomodimi hotel, shpenzime personale. Vlera 160 euro.

Udhëtimet viti 2022:

- ✓ Dalje 17.03.2022 Itali, linjë ajrore, hyrje 21.03.2022, aeroporti "Nënë Tereza" Tiranë, destinacioni Bolonjë, akomodimi hotel, qëllimi privat, shpenzime personale. Vlera 370 euro.
- ✓ Dalje 03.06.2022, Madrid, linjë ajrore, hyrje 07.06.2022, aeroporti "Nënë Tereza" Tiranë, destinacioni, Madrid, akomodimi hotel, qëllimi privat, shpenzime personale. Vlera 490 euro.
- ✓ Dalje 03.09.2022, Durrës - Bari, me automjet me targa AA\*\*\*NM, hyrja me datë 11.09.2022, destinacioni Itali, akomodimi hotel, qëllimi privat, shpenzime personale (me bashkëshortin subjekt). Trajtuar më lart vlera.
- ✓ Shpenzime në shumën 554.810 lekë për kurim në Spitalin jopublik \*\*\*, Tiranë. Tetor 2020, Burimi i shpenzimeve të ardhura personale, ndihmuar nga të afërm motra ime me banim të përhershëm në Amerikë, miq, marrë dhe hua, për shkak të plotësimit të shumës që do të kushtonte ndërhyrja urgjente kirurgjikale dhe kurimi. Huaja e marrë prej meje është likuiduar me 05.12.2020, vërtetuar me tërheqjen nga llogaria bankare në Raiffesien Bank, me nr. llog. 2100855\*\*\*. Faturë tatimorë shitje Spitali \*\*\* Hospital sha. nr. invoice 355903\*\*\*, datë 15.10.2020. Veprime bankare, tërheqja nga llogaria nr. llog. 2100855\*\*\*, nr. veprimi ren-\*\*\*, datë 04.12.2020, Raiffeisen Bank.
- ✓ Raiffeisen Bank me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 27.07.2023, ka b/lidhur nxjerrje llogarie bankare të Niko Brahimaj, ku në datë 04.12.2020, është tërhequr cash shuma 1.000.000 lekë, për shpenzime personale.

Në proces verbalin e datës 30.11.2023, subjekti u pyet në lidhje me shpenzimet për udhëtim dhe shpenzimet shëndetësore dhe paraqitja e dokumentacionit përkatës.

Në inventarin e datës 20.12.2022, paraqiti shpjegime, ku sqaroi se ai dhe b/shortja, gjatë vitit 2020, nuk kanë kryer udhëtime.

Subjekti ka udhëtuar për qëllime pune në dt. 17.07.2022 dhe hyrje 21.07.2022, për të cilin paraqiti urdhër shërbimi, pa shpenzime personale.

Subjekti ka specifikuar udhëtimet dhe shpenzimet përkatëse, si më poshtë:

Udhëtime viti 2021: Personi i lidhur (bashkëshortja)

Kosovë 15 - 16.03.2021, shpenzuar 160 euro. Akomodimi në hotel "\*\*\*\*" një natë, 1/3 pjesë + ushqim + shpenzime udhëtimi.

Turqi (subjekti dhe bashkëshortja) 18-20 shtator 2021, kanë shpenzuar 1.300 euro. Akomodimi tek miqtë e subjektit në Eskisehir, bileta e avionit dhe shpenzime të tjera.

Udhëtime viti 2022: Bolonja - Firenze Itali (bashkëshortja) 17 mars - 21 mars 2022, vlera 370 euro. Akomodim në hotel, 1/3 =366/3, udhëtimi 1/3 =227/3 + shpenzime të tjera.

Në lidhje me konstatimin e Tim-sit, ku b/shortja ka të regjistruar vetëm dalje, dt. 27.03.2022, në pikën kufitare Morina, me autoveturë AB\*\*\*EM, pasi sistemi nuk ka regjistruar hyrjen, sqaron se ajo ka shkuar në Kosovë dhe është kthyer brenda ditës, shpenzime minimale, nuk disponon dokumentacion. Madrid, Spanjë (bashkëshortja) 3 - 6 qershor, 490 euro. Akomodim në hotel, 190 euro në dhomë treshe, Fluturimi 135 euro + shpenzime të tjera. Itali, Sicili (subjekti dhe bashkëshortja) 03 - 11.09.2022, 3.000 euro. Udhëtimi me bashkëshorten dhe 3



familjarë. Shpenzimet më poshtë i referohen pjesës së subjektit dhe bashkëshortes. Shpenzime udhëtimi: Biletat e tragetit 421 euro, shpenzime me makinë 500 euro. Gjithsej 921 euro. Shpenzime hoteli - Alberobelo 1 natë, 100 euro shtëpi Airbnb; Taormina 2 netë shtëpi Airbnb 230 euro; Sirakuzza, 1 natë 195 euro; Palermo, shtëpi Airbnb 1 natë 90 euro, 1 natë Sirakuza 80 euro, 1 natë Mesina 80 euro, 1 natë Valenta 112 euro. Gjithsej 887 euro. Shpenzime ushqim, etj. 1.192 euro.

✓ Subjekti ka specifikuar shpenzimet e deklaruara në vlerën 5.320 euro.

42. Në lidhje me shpenzimet e udhëtimeve të deklaruara subjekti nuk ka fatura për udhëtimin, hoteleri dhe ushqim. Sqaron se kanë qëndruar edhe nëpër shtëpi me AIRBNB, disa nga udhëtimet janë kryer nëpërmjet kompanive ajrore me bileta ekonomike. Burimi financiar i udhëtimeve janë pagat e subjektit dhe të b/shortes. Në lidhje me shpenzimin shëndetësor në v. 2020, në Spitalin \*\*\* ka kryer një ndërhyrje të shpejtë kirurgjikale, me një faturë në shumën 4.700 euro, me burim nga të ardhurat personale ndihmë nga afërm dhe miq. Konkretisht këtë shumë ia ofroi miku i tij z. E.R., me burim pagat e tij (për të cilin nuk disponon dokument), dhe shlyerja e borxhit u bë në datë 5 dhjetor. Shtoi se ka përfutuar dhe ndonjë ulje në lidhje me shpenzimet mjekësore.

Në lidhje me këtë marrëdhënie borxhi me mikun e tij E.R., subjekti nuk ka kryer asnjë veprim formal (deklaratë, kontratë huaje), për shkak të urgjencës shëndetësore në v. 2020 dhe raportit në mirëbesim me Z. R., por e ka kryer me deklaratë noteriale në v. 2023.

Subjekti ka shtuar se motra e tij A.B.me banim të përhershëm në Amerikë, shtetase \*\*\*e, në vitin 2021 gjatë vizitës së saj të rradhës në Shqipëri i ka dhuruar shumën 5.000 usd si ndihmë për problemin shëndetësor të kaluar nga subjekti disa muaj më parë. Paraqiti deklaratë nga motra e tij, A.B.

Paraqiti:

Kopje e TIMS-it, në emër të Niko Brahimaj, për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022, ku rezultojnë hyrje - dalje, si më poshtë;

Dalje datë 02.09.2022, hyrje në datë 11.09.2022, me linjën Bari, Rigel Duni, me mjetin me targa AA\*\*\*NM.

Dalje datë 17.07.2022, hyrje në datë 21.07.2022, linjë ajrore Australian Airlines Viena.

Dalje datë 08.09.2021, hyrje me datë 20.09.2021, linjë ajrore Tiranë - Stamboll.

43. Kopje e TIMS-it, në emër të Sadete Rringaj, për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022, ku rezultojnë hyrje -dalje, si më poshtë;

Dalje, datë 02.09.2022, hyrje në datë 11.09.2022, me linjën Bari Rigel Duni.

Dalje, datë 03.06.2022, hyrje me datë 07.06.2022, me linjë ajrore WizzAir, për Madrit.

Dalje, datë 27.03.2022, në pikën kufitare Morina, me autoveturë AB\*\*\*EM.

Dalje, datë 17.03.2022, hyrje me datë 21.03.2022, me linjë ajrore WizzAir, Bolonja.

Dalje, datë 08.09.2021, hyrje me datë 20.09.2021, linjë ajrore Tiranë - Stamboll.

Dalje, datë 15.03.2021, hyrje me datë 16.03.2021, pika kufitare Morina

Kopje e TIMS-it, në emër të Sadete Rringaj, për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022, ku rezultojnë hyrje - dalje, si më poshtë;

Dalje, datë 02.09.2022, hyrje në datë 11.09.2022, me linjën Bari Rigel Duni.

Dalje, datë 03.06.2022, hyrje me datë 07.06.2022, me linjë ajrore WizzAir, për Madrit.

Dalje, datë. 27.03.2022, në pikën kufitare Morina, me autoveturë AB\*\*\*EM.

Dalje, datë 17.03.2022, hyrje me datë 21.03.2022, me linjë ajrore WizzAir, Bolonja.

Dalje, datë 08.09.2021, hyrje me datë 20.09.2021, linjë ajrore Tiranë - Stamboll.

Dalje, datë 15.03.2021, hyrje me datë 16.03.2021, pika kufitare Morina.

44. Tërheqja nga Ilogaria bankare dt. 04.12.2020, në RFZ Bank, në emër të Niko Brahimaj në shumën 1.000.000 lekë, me përshkrimin shpenzime personale.

- ✓ Marrëveshje financiare me spitalin \*\*\*, tetor 2020, në emër të Niko Brahimaj për kurimin e tij. Epikrizë mjekësore datë 20.10.2020, nga spitali \*\*\*, në emër të Niko Brahimaj.
- ✓ Faturë dt.15.10.2020, nga Spitali \*\*\*, në emër të Niko Brahimaj për shërbimet e kryera, në shumën 582.810 lekë.
- ✓ Faturë tatimore shitje nr. 355903\*\*\*, datë 15.10.2020, në emër të Niko Brahimaj, në shumën 4.475 euro ose 554.810 lekë. Mandat arkëtimi datë 15.10.2020 nga Niko Brahimaj, në shumën 554.810 lekë. Raport mjekësor.

45. Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 15.12.2023, me deklarues E.R., i cili deklaron se në datë 14.10.2020 i ka dhënë hua shumën 4.700 euro, mikut të tij Niko Brahimaj, me qëllim ndërhyrje kirurgjikale urgjentë pranë Spitalit \*\*\*. Kopje Id- së.

46. Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 19.12.2023, me deklarues E.R., i cili deklaron se në lidhje me vlerën monetare 4.700 euro, të dhënë sipas deklaratës nr. \*\*\*, datë 15.12.2023, ai është likuiduar tërësisht nga shtetasi Niko Brahimaj. Kopje Id- së.

47. Deklaratë datë 19.02.2023, nga A.B, e cila deklaron se gjatë vizitës së saj në Shqipëri, në vitin 2021, i ka dhënë vëllait të saj një shumë prej 5.000 usd në formë ndihme, për problemin shëndetësor të kaluar prej tij në fund të vitit 2020. Burimi janë të ardhurat nga punësimi i saj në kompaninë \*\*\*, në adresën; \*\*\* Broadway, \*\*\*-th Floor, New York, 100\*\*\*.

- Subjekti dha shpjegime dhe paraqiti dokumentacion për sa i përket hyrje - daljeve nga RSH, të tijat dhe të b/shortes, gjatë periudhës 2020 - 2022.
- Subjekti ka dhënë shpjegime dhe paraqitur dokumentacion në lidhje me hyrje daljet nga RSH, gjatë periudhës 2020 - 2022, të cilat rezultojnë në vlerën totale rreth 5.320 euro.
- Lidhur me shpenzimet shëndetësore të deklaruara në shumën rreth 555.000 lekë, subjekti ka dhënë shpjegime dhe paraqitur dokumentacion justifikues për burimin e përdorur, konkretisht nga huamarrja në v. 2020 dhe më pas ndihma financiare e dhënë nga motra e tij në v. 2021.

#### 48. TE DHËNA KONFIDENCIALE

- Apartament banimi ndodhur në ZK 8270, nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, me adresë rruga \*\*\* Hyrja nr.\*\*\*, Apartamenti \*\*\*, Tiranë. Sipërfaqja e apartamentit 94.75 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e përbashkët 9.15 m<sup>2</sup>, në total 103.9 m<sup>2</sup>. Blerë në shumën 41.560 Usd, pjesa takuese 100%. Kontratë shitje pasuri e paluajtshme (apartament) nr. \*\*\*, datë 21.06.2013, pala shitëse: Gj. H., ID G51005\*\*\*P Pala Blerëse: Niko Brahimaj; Certifikatë për vërtetim pronësie, nr. \*\*\*, ZK 8270, me nr. pasurie \*\*\*, Tiranë.
- Shitje e automjetit Land Rover tip LTG Discovery, viti i prodhimit 2002, nr. shasië SALLTGM 842A760\*\*\*, me targë TR\*\*\*P, shitur me kontratë shitblerje automjeti nr. \*\*\*rep. nr.\*\*\* kol. datë 12.05.2016, në shumën 6.000 euro.

- Shitje automjeti tip Land Rover Discovery 3, viti i prodhimit 2008, me targa AA\*\*\*ON, shitur sipas kontratë shitblerje automjeti nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.05.2020, në shumën 6.500 euro. Trajtuar më lart.

## **DEKLARIMI 1 BASHKËSHORTES - SADETE RRINGAJ**

### **DEKLARIMI I PASURIVE**

49. 4. **Blerje Garazh në ZK. 8270, nr. pasurie \*\*\*, në adresën rruga "\*\*\*\*", Tiranë, me sipërfaqe 34.7 m2. Regjistruar në 27.12.2006, data e transaksionit 28.12.2006. Burimi i krijimit: Kursime personale nga punësimet. Vlera 8.000 usd. Pjesa takuese: 100%.**

ASHK, Drejtoritë Vendore, Tirana Rurale 1, Tirana Rurale 2, Tirana Veri, Zona të Stimuluara, nuk konfirmojnë pasuri të regjistruar në emër të b/shortes.

### **Hetimi i kryer nga Trupa Vlerësuese pranë AMP.**

- ✓ Në proces verbalin e datës 30.11.2023, subjekti u pyet në lidhje me burimin financiar për blerjen e garazhit.
- ✓ Në inventarin e datës 20.12.2023 paraqiti shpjegime, ku subjekti ka sqaruar se burimi financiar për krijimin e kësaj pasurie është nga të ardhurat e akumuluar ndër vite nga punësimi i tij dhe i b/shortes. Paguesa është kryer cash, dhe nuk disponon mandat pagesë.

### **Dokumentacioni shoqërues:**

- ✓ Vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. \*\*\*, datë 05.03.2007, nga ZVRPP Tiranë të pasurisë nr. \*\*\*, e llojit garazh me sip. 36.7 m<sup>2</sup>, në Zk. 8270, në Rr. "\*\*\*\*", e regjistruar në emër të Sadete Rringaj. Harta treguese e regjistrimit.
- ✓ Kontratë shitblerje nr. \*\*\*, datë 28.12.2006, me palë shitëse shoqëria "\*\*\*\*" ShPK dhe palë blerëse Sadete Rringaj (Brahimaj), të një garazhi me një sip. 36.7 m<sup>2</sup>, të ndodhur në adresën Rr. "\*\*\*\*" Tiranë, e regjistruar me nr. hipotekor \*\*\*, datë 24.07.2006, ZK 8270, me nr. pasurie \*\*\*. Shitësi shet pasurinë e regjistruar në emër të tij, në vlerën 8.000 euro, vlerë e shlyer tërësisht jashtë zyrës noteriale.
- ✓ Vërtetim nga dokumenti hipotekor nr.\*\*\*, datë 24.07.2006, nga ZVRPP Tiranë të pasurisë nr. \*\*\*, e llojit garazh me sip. 36.7 m<sup>2</sup>, ZK8270, Rr."\*\*\*\*" e regjistruar në emër të shoqërisë "\*\*\*\*" shpk. Harta treguese e regjistrimit. Genplan i garazhit me sip. 36.7 m<sup>2</sup>.
- Bazuar në deklarin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:
- ✓ Garazhi me sip. 36.7m<sup>2</sup>, në Rr. "\*\*\*\*" Tiranë, në pronësi të b/shortes është blerë në dhjetor 2006, në shumën 8.000 euro, me burime të ardhurat familjare. Subjekti ka dhënë shpjegime dhe paraqitur dokumentacion justifikues në lidhje me garazhin me sip. 36.7 m<sup>2</sup> në Tiranë blerë në v. 2006 në emër të b/shortes.
- ✓ ASHK nuk konfirmon regjistrimin e kësaj pasurie.

50. 5. **Blerje automjeti Autoveturë Mazda 2, viti i prodhimit 2002 me targë AA\*\*\*KD. Akt Shitje i automjetit me targa AA\*\*\*KD, nga I.T., person fizik, me NIPT K72110\*\*\*G, Rrashbull, Durrës dhe fatura tatimore shitje nr.\*\*\*, datë 10.09.2014, në shumën 159.308 lekë.**

Burimi i krijimit: Kursime personale nga punësimet. Vlera 159.308 lekë. Pjesa takuese: 100%.

✚ DPSHTRR me shkresën nr. \*\*\* prot., dt. 10.08.2023, konfirmon se Sadete Rringaj ka pasur të regjistruar mjetin me targa AA\*\*\*KD. B/lidhur dosja e mjetit me targa AA\*\*\*KD.

**Bashkëlidhur dokumentacioni:**

- ✓ Akt Shitje me nr. \*\*\*, datë 10.09.2014, me palë shitëse I.T., me NIPT K72110\*\*\*G, në adresën Shenvlash, tregu i makinave në Rrashbull, Durrës, i cili deklaron se i ka shitur shtetases Sadete Rringaj, mjet me nr. shasje JMZNEAWP3J36\*\*\*. Faturë tatimore shitje nr. \*\*\* datë 10.09.2014, me palë shitëse I.T. me NIPT K72110\*\*\*G, me palë blerëse Sadete Rringaj, mjet i llojit Mazda, me nr. shasje JMZNEAWP3J36\*\*\*, në vlerën 159.308 lekë.
- ✓ Kontratë Shitje nr. \*\*\*, datë 07.10.2021, me palë shitëse Sadete Rringaj, me palë blerëse E.B., të mjetit tip Mazda, me targa AA\*\*\*KD, me nr. shasje JMZNEAWP3J36\*\*\*. (dokument i paplotë). Praktika e mjetit.

✚ DPSHTR me postën elektronik të datës 13.11.2023, ka b/lidhur: Kontratë Shitje nr. \*\*\*, datë 07.10.2021, me palë shitëse Sadete Rringaj, me palë blerëse E.B., të mjetit tip Mazda, me targa AA\*\*\*KD, me nr. shasje JMZNEAWP3J36\*\*\*, në vlerën 150.000 lekë. Praktika e mjetit.

- ✓ Në proces verbalin e datës 30.11.2023, subjekti u pyet në lidhje me burimin financiar për blerjen e mjetit.
- ✓ Në inventarin e datës 20.12.2023 paraqiti shpjegime ku subjekti sqaroi se autovetura tip MAZDA 2, me targa AA\*\*\*KD është blerë në vlerën 159.308 lekë, me burim kursimet familjare nga pagat. Kjo është vlera reale sipas kontratës.

51. Paraqiti:

- ✓ Dosje e mjetit me targa AA\*\*\*KD. Akt Shitje me nr. \*\*\*, datë 10.09.2014, me palë shitëse I.T., me NIPT K72110\*\*\*G, në adresën Shenvlash, tregu i makinave në Rrashbull, Durrës, i cili deklaron se i ka shitur shtetases Sadete Rringaj, mjet me nr. shasje JMZNEAWP3J36\*\*\*. Praktika e personit fizik I.T. + praktika e mjetit.
  - ✓ Konstatohet se automjeti tip Mazda me targa AA\*\*\*KD, është blerë nga b/shortja e subjektit në v. 2014 në shumën 159.308 lekë dhe është shitur në v. 2021 në shumën 150.000 lekë.
- Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.

52. **6. Blerje automjeti Mercedes Benx, modeli GLK 220 CDI 4 Matik, me targa AB\*\*\*EM nr. shasje, WDC2049841F936\*\*\*, viti i prodhimit 2012**, datë regjistrimi 11.11.2021, datë transaksioni 29.10.2021. Kontratë shitje automjeti midis shoqërisë \*\*\* shpk NIPT L41812\*\*\*C. Burimi i krijimit: Burime nga shitja e mjetit personal tip Mazda, në vlerën 150.000 lekë dhe kursime personale. Vlera: 550.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

✚ DPSHTRR me shkresën nr. \*\*\* prot., dt. 10.08.2023, konfirmon se Sadete Rringaj ka të regjistruar mjetin me targa AB\*\*\*EM. B/lidhur dosja e mjetit.

Kontratë shitje automjeti datë 27.10.2021, me shitës A.C.R, me NIPT: L41812\*\*\*C dhe palë blerëse Sadete Rringaj, te mjetit Mercedes Benx, modeli GLK 220 CDI 4 Matik, me targa AB\*\*\*EM, në vlerën 4.500 euro, sipas faturës me nr. 76/39/2021, e lëshuar datë 27.10.2021. Fatura tatimore nr. \*\*\*, datë 27.10.2021, me blerëse Sadete Rringaj për blerje mjeti në vlerën 4.500 euro, vlera 549.360 leke. Praktika e mjetit.

- ✓ Në inventarin e datës 20.12.2023 subjekti ka shtuar se të ardhurat e përfituara nga shitja e mjetit Mazda kanë shërbyer si burim për blerjen e mjetit Mercedes Benx, me targa AB\*\*\*EM, si dhe kursimet familjare.
- ✓ Konstatohet se automjeti tip Mercedes Benx, modeli GLK 220, me targa AB\*\*\*EM është blerë në v. 2021, në shumën 4.500 euro lekë, deklaruar në formularët e deklarimit në vlerën 550.000 lekë, me burim nga të ardhurat familjare dhe pjesa tjetër nga shitja e automjetit tip Mazda, në vlerën 150.000 lekë.
- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.

### 53. DEKLARIMI TË ARDHURAVE

- Të ardhurat nga paga neto si mësuese në shkollën 8-vjeçare “Migjeni” Pukë, për periudhën 2000 - 2001. Vlera 360.000 lekë.
- Të ardhurat nga paga neto, në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit për periudhën 2002 - 2005; 2002 - 322.429 lekë; 2003 - 517.842 lekë; 2004 - 582.174 lekë; 2005 - 729.095 lekë; Total për gjithë periudhën, shuma 2.151.540 lekë.
- Të ardhurat nga paga neto specialiste në Ministrinë e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Decentralizimit dhe Politikave Decentralizuese, për periudhën 2006 - 2009; 2006 - 514.387 leke; 2007 - 535.000 leke; 2008 - 561.600 leke; 2009 - 147.000 lekë; Total për gjithë periudhën, shuma 1.757.987 lekë.
- Të ardhurat për periudhën e papunësisë (listë pritje) prill 2009 - prill 2010, në shumën 72.000 lekë.
- Të ardhurat nga punësimi në sektorin privat, në Agjencinë Turistike "\*\*\*\*" për periudhën prill 2010 - shkurt 2011, në shumën (afërsisht) 150.000 lekë.
- Të ardhura nga paga neto në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, me detyrë specialist i parë dhe Shef sektori për periudhën 2011- mars 2018; 2011- 550.476 lekë; 2012 - 760.545 lekë; 2013 - 781.080 lekë; 2014 - 910.255 lekë; 2015 - 920.439 lekë; 2017 - 1.068.616 lekë; 2018 - 1.068.616 lekë; 2019 - 1.068.616 lekë; 2020 - 1.129.765 lekë;
- Të ardhura nga paga në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe në vazhdim në Kolegjin e Posaçme të Apelimit. 2021 - 895.932 lekë; 2022 - 1.114.312 lekë; mars 2022 - 356.942 lekë; Total për gjithë periudhën deri mars 2023, vlera 10.625.594 lekë.
- Të ardhura nga aktiviteti si person fizik Sadete Rringaj NUIS (NIPT) L82313\*\*\*V. Objekti i veprimtarisë; Përkthim me datë fillimi 21.11.2018 - 31.12.2022. Aktualisht me status "Pezulluar". Vlera 766.019 lekë. Burimi i krijimit; Të ardhurat nga puna.
- Shitje Automjeti Mazda 2, viti i prodhimit 2002, me targë AA\*\*\*KD, me kontratë shitje pasuri e (pa)luajtshme (automjeti) me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 07.10.2021, në shumën 150.000 lekë.
- ✚ Raiffeisen Bank, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.07.2023, ka b/lidhur nxjerrje llogarie bankare të Sadete Rringaj, ku i janë kredituar të ardhurat nga pagat për periudhën 03.02.2006 - 02.03.2009, në shumën 1.823.073 lekë.
- ✚ Tirana Bank me shkresën nr. \*\*\* prot., dt. 31.07.2023, konfirmon se Sadete Rringaj, nuk ka llogari personale, por është e lidhur me subjektin "\*\*\*\* ShPK" me Nipt K8172\*\*\*G.
- ✚ Credins Bank, me shkresën nr. \*\*\* prot., dt. 16.10.2023, ka b/lidhur nxjerrje llogari bankare të Sadete Rringaj, ku i janë kredituar të ardhurat nga pagat nga AKBN, Ministria e Drejtësisë, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, viti 2005 dhe prill 2011 - 03.03.2023, në shumën 12.947.244 lekë. Ka kaluar dhe paga për periudhën tetor 2004 - dhjetor 2004.
- ✚ QKB, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.07.2023, konfirmon si më poshtë:

- Sadete Rringaj figuron të jetë e regjistruar si ortakë në shoqërinë "\*\*\*\*" ShPK, themeluar në datë 29.04.2008, pajisur me NIPT K81702\*\*\*G. Statusi i shoqërisë është "Shoqëri në likuidim e sipër". B/lidhur, ekstrakt historik i regjistrimit tregtar për subjektin "\*\*\*\*" ShPK, me NIPT K81702\*\*\*G, regjistruar në datë 29.04.2008, me Objekt aktiviteti Agjenci Turistike, shërbime përkthimi & konsulentë, këmbim valutë & sigurime. Kapitali është në shumën 100.000 lekë, ku 50% e aksioneve figurojnë të regjistruara në emër të shtetasës E.C. dhe 50% të aksioneve në emër të Sadete Rringaj. Shoqëria është me status "Shoqëri në Likuidim e Sipër" Administrator është V.M. dhe likuidator shtetasja Sh. H.
- Shtetasja Sadete Rringaj figuron e regjistruar si person fizik e pajisur me NIPT L82313\*\*\*V. Statusi i subjektit është "aktiv". B/lidhur ekstrakt historik i regjistrimit tregtar për subjektin "Sadete Rringaj" Person Fizik, me Nipt L82313\*\*\*V, e regjistruar, me datë 13.11.2018, me veprimtari, "Shërbime në fushën e përkthimit në gjuhën angleze". Në datë 01.07.2019, është regjistruar "Pezullim i aktivitetit pa afat nga data 28.06.2019". Në datë 21.02.2020 është regjistruar "Aktivizim aktiviteti" i cili kalon nga i pezulluar në "aktiv".

✚ DPT me shkresën nr. \*\*\* prot., dt. 02.08.2023, i kërkon informacion të mëtejshëm DRT Tiranë për subjektin deklarues dhe personat e lidhur me të.

✚ DRT Tiranë me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 17.08.2023, nr. \*\*\* prot., datë 06.11.2023, informon dhe kthen përgjigje në lidhje me kërkesën e DPT, si më poshtë: Shtetësja Sadete Rringaj, rezulton e regjistruar si person fizik me NIPT L82313\*\*\*V, e regjistruar në sistem me 13.11.2018. Të ardhurat e deklaruara dhe të regjistruara në sistemin c@ts janë si vijon:

Viti	Qarkullimi	Fitimi	Humbja	Fitimi pas tatimit
V.2018	----	----	----	----
V.2019	----	----	----	----
V.2020	563,787	413,787	----	413,787
V.2021	265,160	173,865	----	173,865
V.2022	768,200	703,160	----	703,160

B/ lidhur: Deklaratat e të ardhurave për vitet 2018 - 2022, informacion në kohë reale. Person fizik, nuk shpërndan dividend.

✚ DRT Tiranë me postën elektronike të datës 21.11.2023, përcjell informacion sipas të dhënave të sistemit tatimor C@ts, në lidhje me subjektin "\*\*\*\*" me NIPT K817020\*\*\*G, se ky biznes rezulton me administratore V.M. Ky subjekt është me status "pasiv" nga 16.12.2014.

✚ ISSH me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 07.08.2023, konfirmon se Sadete Rringaj ka përfituar të ardhura nga punësimi pranë punëdhënësve "Agjencia Kombëtare të Burimeve Natyrore", Sadete Rringaj, "Kolegji i Posaçëm i Apelimit" për periudhën janar 2012 - qershor 2023.

Në proces verbalin e datës 30.11.2023 subjektit iu kërkuar të paraqesë dokumentacion justifikues ligjor, për të ardhurat e b/shortes dhe shpjegime në lidhje me konstatimin e institucioneve tatimore.

Në inventarin e datës 20.12.2023 paraqiti shpjegime: Në lidhje me punësimet e bashkëshortes për periudhat e kërkuara 2000 - 2001, 2002 - 2005, paraqiti dokumentacion ligjor. Lidhur me pagesën e papunësisë, sqaroi se kjo periudhë ka qenë në prill 2009 - prill 2010, pagesë e marrë përmes Postës së Shqipërisë rreth 6.000 lekë/muaj, për të cilat paraqiti dokumentacion. Lidhur me pjesëmarrjen e b/shortes në shoqërinë "\*\*\*\*" shpk, themeluar në datë 29.04.2008, me NIPT: K817020\*\*\*G, subjekti sqaroi se kjo shoqëri ka pasur aktivitet shumë të shkurtër dhe si i tillë, nuk ka pasur fitime dhe të ketë siguruar të ardhura financiare. Prej shoqërisë nuk janë kryer shpërndarje, dividend. Sqaroi se shuma e investuar nga b/shortja në vlerën 50.000 lekë ka burim financiar të ardhura nga kursimet familjare. Nuk disponon dokumentacion në lidhje me



të ardhurat në shumën 150.000 lekë, të deklaruar nga b/shortja, por rideklaron se b/shortja ka përfituar shumën 150.000 lekë, si pagë pranë në shoqërinë ”\*\*\*” ShPK.

54. Në lidhje me aktivitetin privat të b/shortes Sadete Rringaj, si PF me NUIS (NIPT) L82313\*\*\*V, me objekt të aktivitetit ”Përkthim”, subjekti ka sqaruar se është regjistruar me datë 13.11.2018 dhe ka ushtruar aktivitetet deri më 01.07.2019. Me kërkesën e datës 01.07.2019, me nr. çështje CN-246377\*\*\*, biznesi ka kaluar në status “Pezulluar”. Me datë 21.02.2020, me nr. çështje CIV-471968\*\*\*, është kryer aktivizimi si PF dhe ka kaluar në status “Aktiv”. Në lidhje me deklarimin e statusit “Pezulluar” në momentin e deklarimit b/shortja ka dashur të përfshijë dhe periudhën e pezulluar të aktivitetit të saj, (ka të bëjë me një lapsus), por më pas ka kaluar në status aktiv, referuar edhe përgjigjes së ardhur nga DRT Tiranë, të cilën subjekti e konfirmon plotësisht. Sqaroi se b/shortja ka deklaruar me përafërsi të ardhura nga aktiviteti i saj, për v. 2022. Subjekti konfirmon të ardhurat e përfituara nga biznesi i b/shortes si person fizik, sipas vërtetimit të DRT Tiranë. Gjatë kësaj periudhe b/shortja ka ushtruar aktivitetin si përkthyes zyrtare e njohur nga Ministria e Drejtësisë dhe ka pasur kontratë me Ministrinë e Drejtësisë dhe kontrata porosie për disa përkthime nga Autoriteti për Informimin e Dokumenteve të ish Sigurimit të Shtetit. Pagesat e kryera nga këto dy institucione gjatë kësaj periudhe janë bërë pa faturë me tatim në burim, ku këto pagesa kanë kaluar në Llogarinë në Credins Bank, me sa i kujtohet, në fund të dhjetorit 2019. Më tej, pas riaktivizimit në 21.02.2020 ka vijuar me kontrata, nga dy institucionet e mësipërme me faturim.

55. Në lidhje me zhvillimin e aktivitetit privat për bashkëshorten si PF, e cila ka qenë e punësuar njëkohësisht pranë AKBN, sqaron se vendi i punës nuk ka qenë më Status Civil, apo të ketë qenë subjekt i Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 (i ndryshuar), me qëllim sjelljen e pengesës ligjore për ta ushtruar aktivitetin si "përkthyes" kryer më kohë të pjesshme. B/shortja ka qenë e punësuar sipas kritereve të punësimit në respektim të Kodit të Punës. Sqaroi se AKBN është institucion i varësisë së Ministrisë së Energjetikës dhe trajtohet si “Ndërmarrje”. Ndërsa për rastin e punësimit aktual pranë Kolegji i Posaçëm i Apelit, ka marrë dakortësinë nga titullari dhe bashkëlidhur paraqiti dokumentacionin e lejes së ushtrimit të përkthyeses me kohë të pjesshme.

56. Sqaroi në lidhje me të ardhurat e b/shortes, se janë deklaruar me përafërsi, mund të mbartin edhe lapsus në mbledhjen tyre.

#### **Dokumentacioni shoqërues:**

- ✓ Libreze pune në emër të Sadete Rringaj, e cila ka përfituar “Pagesë papunësie” nga Zyra Rajonale e Punësimit Tiranë, për periudhën 01.03.2009 - 01.03.2010.
- ✓ Vërtetim nr. \*\*\* prot., dt. 25.09.2009, nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit që konfirmon se Sadete Rringaj trajtohet me pagesë papunësie, duke filluar nga 28.02.2009 e në vazhdim me pagë mujore 6.340 lekë. (Llogaritur vlera 76.080 lekë)
- ✓ Vërtetim për bazën vlerësueshme dhe pagën neto mesatare në emër të Sadete Rringaj, e cila ka përfituar të ardhura nga punësimi për periudhën 16.09.2000 - 31.08.2001, në shumën 131.097 lekë.
- ✓ Vërtetim për bazën vlerësueshme dhe pagën neto mesatare nr. \*\*\* prot., dt. 27.08.2020, nga ISSH në emër të Sadete Rringaj e cila ka përfituar të ardhurat nga punësimi për periudhën maj 2002 - dhjetor 2004, në shumën 1.472.635 lekë.

- ✓ Gjithashtu konfirmohen të ardhurat nga paga për periudhën janar 2005 - shkurt 2009, dhe 12.04 2011 - dhjetor 2012.
- ✓ Ekstrakt historik të punonjësit nga DPT, në emër të Sadete Rringaj, për periudhën dhjetor 2011 - tetor 2020, e punësuar pranë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore. Informacion i përgjithshëm nga sistemi C@ts për subjektin "\*\*\*\*" ShPK., me NIPT K817020\*\*\*G, me aktivitet të agjencive të udhëtimit dhe të turizmit, e regjistruar në datë 02.05.2008, me status pasiv në dt. 16.04.2014. Formular i deklarimit dhe pagesës së tatimit në burim, për subjektin "\*\*\*\*" ShPK., për periudhën 2009 - 2012, rezultojnë të ardhura, shpenzime, në vlerën 0 lekë. Detyrimet në kohë reale më dt. 28.05.2021, janë në shumën 35.000 lekë, në emër të administratorit V.M.
- ✓ Pasqyra financiare për subjektin "\*\*\*\*" ShPK., me NIPT K817020\*\*\*G, për vitin 2009, ku totali i pasqyrave rezulton pa vlera financiare.
- ✓ Certifikata regjistrimi për personin e tatueshëm Sadete Rringaj, me NIPT L82313\*\*\*V, datë regjistrimi 13.11.2018.
- ✓ Ekstraktit historik të PF Sadete Rringaj, me NIPT L82313\*\*\*V, e regjistruar në sistem më datë 13.11.2018, me status aktiv. Në datë 01.07.2019, është regjistruar "Pezullim i aktivitetit pa afat", nga data 28.06.2019. Në datë 21.02.2020 është regjistruar "Aktivizim aktiviteti", i cili kalon nga i "pezulluar" në "aktiv"
- ✓ Shkresë datë 12.05.2022, nga Kolegji Posaçëm i Apelimit, mbi angazhimin si përkthyes i jashtëm i znj. Rringaj, ku konfirmon se aktiviteti për përkthime zyrtare pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe rast pas rasti pranë AIDSSH-së, nuk përbën konflikt interesi, por as pengesa për veprimtarinë që Sadete Rringaj do të kryej, jashtë detyrës së saj zyrtare. Drejtoria e Menaxhimit të Çështjeve pranë këtij institucioni është dakord me angazhimin e Sadete Rringaj si përkthyes jashtëm në Ministrinë e Drejtësisë dhe AIDSSH-së, pa penguar veprimtarinë e përditshme të institucionit.
- ✓ Të ardhurat nga paga e b/shortes, për periudhën shtator 2000 - 03.03.2023, rezultojnë në vlerën totale rreth 16.450.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat neto të b/shortes nga aktiviteti si Person Fizik, me NIPT L82313\*\*\*V për periudhën 2018 - 2022. konfirmohen në vlerën rreth 1.291.000 lekë.
- ✓ B/shortia ka qenë aksionare me 50% të aksioneve pranë shoqërisë. "\*\*\*\*" sh.p.k. me NIPT K817020\*\*\*G, por nuk ka krijuar të ardhura dhe me status "pasiv" nga data 16.12.2014.  
B/shortia ka deklaruar në seksionin e të ardhurave:
  - Llogari rrjedhëse (paga) bankare Banka Credins Sha nr. llogarisë: 00000287\*\*\*. Balanca deri më 31.12.2022, në shumën 761.621 lekë. Burimi i krijimit;
  - Të ardhurat nga pagat AKBN deri në shtator 2021 dhe në vijim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit dhe shpërblime në punë. Vlera 761.621 lekë.
  - Credins Bank me shkresën nr. \*\*\* prot., dt. 16.10.2023, konfirmon se Sadete Rringaj ka llogari page me balancë në datë 03.03.2023, në vlerën 1.086.257 lekë. B/lidhur nxjerrje llogari bankare page, ku balanca në dt. 31.12.2022, është në vlerën 761.621 lekë.

Në proces verbalin e datës 30.11.2023 subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me konfirmimin e Credins Bank dhe deklarimin në seksionin e të ardhurave.

57. Në inventarin e datës 20.12.2023 subjekti ka sqaruar se në këtë llogari kalon paga e b/shortes, kjo është arsyeja që e ka deklaruar në seksionin e të ardhurave, subjekti



konfirmon gjendjen e llogarisë sipas konfirmimit të Credins Bank, në mars 2023, llogaria e b/shortes në Credins Bank, në datë 03.03.2023 ka gjendje 1.086.000 lekë, kurse deklarimi i është referuar gjendjes deri në datë 31.12.2022.

58. **7. Llogari individuale, pranë Banka Credins sha. nr. llogarie: 100001364\*\*\*, çelur me datë 17.04.2020. Pjesa takuese 100%. Balanca në datë 31.12.2022 në shumën 1.000.000 lekë.** Burimi i krijimit: Të ardhurat e krijuara nga pagat dhe aktiviteti privat "Përkthyes". Credins Bank me shkresën nr. \*\*\* prot., dt. 16.10.2023, konfirmon se Sadete Rringaj ka llogari me balancë, në datë 03.03.2023, në vlerën 1.000.000 lekë. B/lidhur nxjerrje llogarie bankare në dt. 17.04.2020, çelur në shumën 600.000 lekë.

Në inventarin e datës 20.12.2023 paraqiti shpjegime, ku subjekti sqaroi se llogaria është e deklaruar në seksionin e të ardhurave, pasi burimi financiar është nga të ardhurat nga pagat e b/shortes dhe aktiviteti.

Konstatohet: Llogaria e b/shortes në Credins Bank është hapur në v. 2020, në shumën 600.000 lekë dhe shtuar në Vitin 2021, në shumën 400.000 lekë, me burim të ardhurat nga pagat dhe aktiviteti i saj.

✓ **Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e ardhur nga Credins Bank.**

59. Banka Credins: Depozitë interesi me afat 24 mujor, në valutën lekë me nr. 1008\*\*\*. çelur me datë 17.12.2004, me vlerë fillestare 50.000 lekë, me afat 3- mujore. Pjesa takuese 100%. Balanca në datë 31.12.2022, në shumën 1.000.000 lekë. Shënim: Kjo depozitë interesi është krijuar nga të ardhurat që rrjedhin nga llogaria nr. llog. D100001364\*\*\*, çelur në datë 17.04.2020. Credins Bank me shkresën nr. \*\*\* prot., dt. 16.10.2023, konfirmon se Sadete Rringaj ka depozitë bankare, me balancë në datë 03.03.2023, në vlerën 1.000.100 lekë. B/lidhur nxjerrje llogari bankare, ku depozita është çelur në dt.17.12.2004, në shumën 50.000 lekë.

60. Në inventarin e datës 20.12.2023 subjekti paraqiti shpjegime, ku në lidhje me depozitën me afat 24 mujore me nr.1008\*\*\*, sqaroi se data e dytë e deklaruar 17.04.2020, ka të bëjë me ndryshimin e kontratës, e cila lidhet me afatin e maturimit të depozitës nga 12 mujore në depozitë 24-mujore, me burim financiar nga pagat dhe aktiviteti i b/shortes.

✓ Konstatohet: Depozita në Credins Bank, në emër të b/shortes, me gjendje 1.000.100 lekë është çelur në v. 2004, në shumën 50.000 lekë, në v. 2005 ka qenë në shumën 613.000 lekë, në v. 2010 pakësuar në vlerën 300.000 lekë, në v. 2012 ka qenë në shumën 350.000 lekë, dhe është rritur në v. 2014 vlera 50.000 lekë dhe në v. 2016 shuma 200.000 lekë. Në Vitin 2017, shtuar shuma 400.000 lekë. Burimi i krijimit të ardhurat familjare.

✓ Konfirmohet deklarimi për depozitën e b/shortes, me përgjigjen e Credins Bank.

Në inventarin e datës 20.12.2023 në shpjegimet e tij, subjekti sqaroi se deklarimi i fondit të pensionit është lapsus në seksionin e të ardhurave dhe të dhënave konfidenciale.

Paraqiti:

61. Kontratë individuale për anëtarësimin në fondin e pensionit pranë shoqërisë "\*\*\*\*" datë 14.01.2016, në emër të Sadete Rringaj, në vlerën 1.000 lekë në muaj.

- Certifikatë e pronësisë së kuotave nga Credins Pension, në emër të Sadete Rringaj, në datë 31.12.2018, në shumën 39.221 lekë, për kontratën nr. 1004\*\*\*. Pasqyra e transaksioneve për periudhën 14.01.2016 - 31.12.2018, në shumën 37.000 lekë.
- Certifikatë e pronësisë së kuotave, nga Credins Pension, në emër të Sadete Rringaj në datë 31.12.2018, në shumën 16.231 lekë për kontratën nr.1011\*\*\*. Pasqyra e transaksioneve për periudhën 03.05.2018 - 31.12.2018, në shumën 16.000 lekë.
- Certifikatë e pronësisë së kuotave, nga Credins Pension, në emër të Sadete Rringaj në datë 12.12.2019, në shumën 53.301 lekë, për kontratën nr. 1004\*\*\*. Pasqyra e transaksioneve për periudhën 14.01.2016 - 12.12.2019, në shumën 49.000 lekë.
- Certifikatë e pronësisë së kuotave, nga Credins Pension, në emër të Sadete Rringaj në datë 12.12.2019, në shumën 41.450 lekë, për kontratën nr. 1011\*\*\*. Pasqyra e transaksioneve për periudhën 03.05.2018 - 12.12.2019, në shumën 40.000 lekë
- Vërtetim nr. \*\*\* prot, dt. 09.11.2020, nga Credins Invest, që konfirmon se Sadete Rringaj është klientë në fondin e Credins Invest, nga data 14.01.2016, referuar kontratës nr. 1004\*\*\*, në datë 30.10.2020, gjendja është në shumën 65.765 lekë dhe kontrata nr. 1011\*\*\*, në datë 30.10.2020, gjendja është në shumën 62.736 lekë.
- Konstatohet se fondi i investimit të pensionit në Credins Invest, në emër të bashkëshortes, në shumën 317.896 lekë, është me burim nga kontributi mujor i pagës së saj, që nga viti 2016 e në vijim.
- Credins Invest, konfirmon fondin e investimit në emër të b/shortes, me gjendje 350.143 lekë në datë 30.03.2023.

## **62. TË DHËNA KONFIDENCIALE**

- Blerë Garazh në ZK 8270, nr. pasurie \*\*\*, në adresën rruga “\*\*\*\*”, Tiranë, me sipërfaqja 34.7 m<sup>2</sup>. Pjesa takuese: 100%. Kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme nr.\*\*\* datë 28.12.2006. Kartelë e pasurisë së paluajtshme ZK 8270, nr. pasurie \*\*\* NR indeksi hartë TR-\*\*\*\* Tiranë.
- Asset Fonde investimi "Credins Invest". Lloji i Fondit të investimit “Pension”. Shuma e investuar/ Kontributi 189.012 lekë. Datë e linçimit të fondit 14.01.2016. Balanca deri me 31.12.2021, në shumën 317.896 lekë. Pjesa takuese 100%.
- Banka Credins: Depozitë interesi me afat 24 mujor, në valutën lekë, me nr.1008\*\*\*, çelur me datë 17.12.2004, me vlerë fillestare 50.000 lekë, me afat 3- mujor. Balanca në datë 31.12.2022, në shumën 1.000.000 lekë. Shënim: Kjo depozitë interesi është krijuar nga të ardhurat që rrjedhin nga llogaria, nr.100001364\*\*\*, çelur në datë 17.04.2020. Vlera 1.000.000 lekë. Pjesa takuese 100%.
- Blerje automjeti Autoveturë Mazda 2, viti i prodhimit 2002 me targë AA\*\*\*KD, në shumën 159.308 lekë. Akt-shitje nga I.T., person fizik, me NIPT K72110\*\*\*G, Rrashbull, Durrës dhe fatura tatimore shitje nr.\*\*\*, datë 10.09.2014.
- Blerje automjet Mercedes Benx modeli GLK 220 CDI 4 Matik me targa AB\*\*\*EM, nr. shasie, WDC2049841F936\*\*\*, viti i prodhimit 2012, datë regjistrimi 11.11.2021 datë transaksioni 29.10.2021, në shumën 550.000 lekë. Kontratë shitje Automjeti midis shoqërisë “\*\*\*\*” ShPK NIPT L41812\*\*\*C. Trajtuar më lart.
- Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, subjekti, ka deklaruar adresën e plotë ku është regjistruar në Gjendjen Civile, si dhe adresën e plotë ku banon: Njësia Administrative nr. 5. Rr. “\*\*\*\*”, Pallati \*\*\*, Hyrja\*\*\*, Ap. \*\*\*, Tiranë”.

- ✓ Certifikatë personale në emër të Niko Brahimaj, i cili figuron i regjistruar në vendqëndrimin "\*\*\*\*" 0000 Tiranë.
- ✓ Certifikatë familjare, data 21.09.2020. Certifikatë martese datë 01.10.2020, nga Njësia Administrative nr. 5, ku Niko Brahimaj dhe Sadete Rringaj janë martuar në datë 21.07.2003 dhe figurojnë të regjistruar në vendqëndrimin "\*\*\*\*".

63. Në mënyrë të përmbledhur, referuar të dhënave të deklaratës së pasurisë për vlerësimin kalimtar, subjekti dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar deri më datë 03.03.2023, si më poshtë:

1. Apartament banimi me sipërfaqe 94.75 m<sup>2</sup>, në emër të subjektit me adresë rruga "\*\*\*\*", Tiranë, në vlerën 41.560 usd.
2. Garazh me sip. 34.7 m<sup>2</sup>, në rr. "\*\*\*\*", Tiranë, në emër të b/shortes në v. 2006, në vlerën 8.000 euro.
3. Automjet tip Mercedes-Benz, me targa AB\*\*\*\*EM në emër të b/shortes, në vlerën 550.000 lekë.
4. Aktiviteti person fizik Sadete Rringaj NUIS (NIPT) L82313\*\*\*\*V, me Objekt "Përkthim".
5. Llogari page në Banka Credins, në emër të b/shortes në vlerën 761.621 lekë.
6. Depozitë në Credins Bank, në emër të b/shortes, në vlerën 1.000.000 lekë.
7. Fonde investimi në "Credins Invest", në emër të b/shortes, në vlerën 317.896 lekë.
8. Depozitë në Credins Bank, në emër të b/shortes, në vlerën 1.000.100 lekë.
9. Llogari bankare në Raiffeisen Bank, në emër të subjektit në vlerën 1.165.939 lekë. (sipas konfirmimit bankar).

Vlera e pasurisë bruto/neto është 4.795.456 lekë + 41.560 usd + 8.000 euro, e konvertuar rreth 10.219.000 lekë. Subjekti nuk ka detyrime financiare.

(Konvertuar me kursin e këmbimit të BSH, të datës 03.03.2023, ku 1 euro 115.28 lekë; 1 usd =108.3 lekë).

- ✚ Banka e Shqipërisë, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Intesa Sanpaolo, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Banka Procredit, Banka e Parë e Investimeve, Banka e Investimeve, Banka OTP Albania, Raiffeisen Leasing, Porsche Leasing. Albania Leasing, Landesleasing, RFZ Invest, Unioni Financiar i Tiranës, Easypay, Fondi BESA, Institucioni Financiar Noa, Iutecredit Albania, Kredo Financë konfirmojnë se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk janë klientë të tyre, çka konfirmohet me deklarinimin
- ✚ ASHK- Drejtoritë dhe Zyrat Vendore; Krujë, Korçë, Has Skrapar, Kuçovë, Shkodër, Pogradec, Librazhd, Malësi e Madhe, Pukë, Përmet, Tropojë, Fier, Bulqizë, Mallakastër, Peqin, Lushnje. Kavajë, Kolonjë, Durrës, Kamzë, Tepelenë, Gjirokastër, Kurbin, Mat, Dibër, Gramsh, Kukës nuk konfirmojnë pasuri të regjistruara në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të.
- ✚ Raiffeisen Bank me shkresën nr. \*\*\* prot., dt. 27.07.2023, konfirmon se Niko Brahimaj ka llogari page me gjendje në datë 03.03.2023, në vlerën 1.165.939 lekë.
- ✚ Subjekti ka dhënë shpjegime në lidhje me Llogarinë e pagës në RFZ Bank me gjendje në dt. 03.03.2023. në vlerën 1.165.939 lekë, llogari e cila është e deklaruar ndër vite me burim të ardhurat nga paga.

- ✚ Credins Bank me shkresën nr. \*\*\* prot., dt. 16.10.2023, konfirmon se Sadete Rringaj ka pasur llogari Visa Preppaid në lekë që rezulton e mbyllur në dt. 03.03.2023. B/lidhur nxjerrje llogari bankare.
  - ✚ AK Invest, me shkresën nr. \*\*\* prot., dt. 15.08.2023, konfirmon se Niko Brahimaj në datë 3.5.2021 ka përfituar me transfertë monetare shumë 500 euro, të dërguar nga shtetasi L.H Britania e Madhe.
    - Në inventarin e datës 20.12.2023 subjekti paraqiti shpjegime në lidhje me transfertën në AK Invest, ku sqaroi se miku i tij nga Britania e Madhe, L.H të cilin e ka të njohur, i ka dërguar shumë 500 euro, pasi është njohur me situatën shëndetësore dhe operacionin e kryer në Spitalin \*\*\* nr.3, Tiranë.
    - Subjekti ka dhënë shpjegime në lidhje me përgjigjen e AK- Invest.
64. ASHK, Drejtoria Vendore Elbasan, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.06.2023, konfirmon se Niko Brahimaj figuron b/pronar në pasurinë e regjistruar në ZK 8521, vol. \*\*\*, fq.\*\*\*, të llojit apartament me nr. pasurisë \*\*\*. B/lidhur; Kontratë shitje banese nr. \*\*\*, dt. 15.11.1993, midis NK Banesave Elbasan dhe A.B.. Përbërja familjare e vitit 1991, me A.B., L.B., Niko Brahimaj, E.B., T.B., A.B. Kontratë për privatizim banese dt.03.11.1993, midis NK Banesave dhe shtetasit A.B, për apartamentin e ndërtuar në v. 1980, në vlerën 7.884 lekë. Plan Vendosije. Kartela e pasurisë së paluajtshme të apartamentit, me sip.70 m<sup>2</sup>, pasuri nr. \*\*\*, në ZK 8521, vol. \*\*\*, fq.\*\*\*, e regjistruar në emër të A.B., L.B., Niko Brahimaj, E.B., T.B., A.B. Në seksionin e qirave, në përdorim marrëveshje kufizuese etj., është vendosur shënimi: Në dt. 25.05.2017 u bë RVP, në shumë 2.464.700 lekë. Ky regjistrim është i vlefshëm deri në kryerjen e një transaksioni mbi pasurinë e rivlerësuar. Harta treguese + praktika.
- Në inventarin e datës 20.12.2023 subjekti paraqiti shpjegime për konstatimin e ASHK, ku lidhur me këtë pasuri të paluajtshme të konstatuar nga ASHK Elbasan, subjekti nuk ka pasur dijeni për pjesën takuese të kësaj pasurie, të përfituar nga ligji për privatizimin dhe konfirmon se nuk ka as interes as pretendim për posedimin apo përdorimin e kësaj prone. Duke qenë se është larguar nga familja, që me fillimet e studimeve të larta 1987, me pas me angazhime pune të ndryshme nëpër gjithë Shqipërinë, ky rast mos pasqyrimi ka qenë përjashtimi i tij nga kjo pronë, duke mos qenë bashkëpronar në këtë pasuri. Aktualisht ka filluar procedurën për heqjen dorë nga kjo e drejtë e bashkëpronësisë, pranë zyrës noteriale "\*\*\*\*", në Tiranë, ku paraqiti deklaratë personale për heqjen dorë nga pjesa takuese e pronës në Elbasan. (dorëzuar pranë zyrës noteriale). Paraqiti:
- ✓ Kartelë e pasurisë së paluajtshme, me nr. \*\*\*, zk. 8521, të apartamentit me sip. 70 m<sup>2</sup>, në Elbasan, e regjistruar në emër të b/pronareve "Brahimaj ku figuron dhe Niko Brahimaj. Përbërja familjare. Plan Vendosije. Praktika.
  - ✓ Deklaratë personale, datë 19.12.2023, nga Niko Brahimaj, i cili deklaron me përgjegjësi të plotë personale, se heq dorë nga pjesa e tij takuese prej 1/6, në pasurinë e llojit apartament, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, fq.\*\*\*, ZK 8521, me adresë Elbasan.
  - ✓ Deklaron se procedurat përkatëse sipas ligjit, po ndiqen pranë zyrës së noterisë G. K Tiranë.
65. Me postën elektronike të datës 17.01.2024. subjektit ka shpjeguar se në apartamentin me sip. 70 m<sup>2</sup>, në Elbasan, të përfituar me kontratë privatizimi, banon poseduesi i pasurisë, sipas certifikatës së pronësisë. Subjekti ka dhënë shpjegime dhe paraqiti dokumentacion justifikues ligjor, në lidhje me konstatimin e ASHK Elbasan. Subjekti ka filluar procedurat për heqjen

dorë nga pjesa takuese prej 1/6 pjesë të apartamentit me sip. 70 m<sup>2</sup>, në Elbasan, të përfutur nëpërmjet privatizimit.

66. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesave, u bë analiza e të dhënave të deklaruara nga subjekti me informacionet e ardhura nga institucionet e specializuara, proces nga i cili, në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se:

- ✓ Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, pasuria totale deri në datë 03.03.2023 është deklaruar bruto/neto 4.795.456 lekë + 41.560 usd + 8.000 euro, konvertuar rreth 10.219.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat e subjektit nga paga, shpërblime, honorarë, veshje, etj., për periudhën shtator 1991 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 20.028.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat nga paga e b/shortes, për periudhën shtator 2000 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 16.450.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat neto të b/shortes nga aktiviteti si Person Fizik, me NIPT L82313\*\*\*V, për periudhën 2018 - 2022, konfirmohen në vlerën rreth 1.291.000 lekë.
- ✓ Për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022 janë shpenzuar për, ujë, drita, telefon dhe internet, etj., në total rreth 176.000 lekë.
- ✓ Për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022 janë shpenzuar për udhëtime nga subjekti dhe b/shortja, në total rreth 5.320 euro e konvertuar në shumën rreth 613.000 lekë.
- ✓ Për periudhën deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, ka deklaruar shpenzime shëndetësore, në shumën rreth 555.000 lekë.
- ✓ Për periudhën 2000 - 03.03.2023, referuar treguesve statistikorë të INSTAT, janë shpenzuar minimalisht për konsum familjar, rreth 8.258.741 lekë.
- ✓ Për periudhën deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, ka deklaruar shpenzime për mobilimin, në shumën rreth 530.000 lekë.

67. **Në përfundim të hetimit të kryer:** Trupa e vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ka analizuar dhe verifikuar të dhënat e mbledhura nga institucionet e ndryshme dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 i ndryshuar, në vlerësimin përfundimtar, bazuar në parimin e kontradiktorialitetit u mbështet edhe në shpjegimet që dha subjekti pas dërgimit të relacionit si dhe ato në seancën dëgjimore dhe në përfundim arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit z. Niko Brahimaj:

- ✓ *Ka bërë deklaram të saktë, në përputhje me ligjin, me burime të ligjshme financiare;*
- ✓ *Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- ✓ *Nuk është kryer fshehje e pasurisë;*
- ✓ *Nuk është kryer deklaram i rremë;*
- ✓ *Subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit;*

## B. KONTROLLI I FIGURËS

68. Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar,

kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

69. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre element:

1. Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
2. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
3. Verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, germa (ë), e ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

70. Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit Z. Niko Brahimaj, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë të deklarimeve si dhe të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.

71. **Për kontrollin e figurës Trupa e vlerësimit administroi:**

- a) Deklaratën e Kontrollit të Figurës.
- b) Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

72. Struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore (AMP) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit Z. Niko Brahimaj , me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim të identifikojë nëse subjekti i vlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018 të ndryshuar, ka dërguar raportin përfundimtar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.12.2023, për subjektin e vlerësimit, në përputhje me nenin 42, pika 2, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, dhe konstaton se:

- ✓ *Formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit Nr. 12/2018, i ndryshuar,*
- ✓ *Për subjektin e vlerësimit Z. Niko Axhem Brahimaj, me detyrë Drejtor Instituti i Policisë Shkencore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe "personave te lidhur", nuk administrohen të dhëna, fakte apo prova, që punonjësi është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, apo që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar*

73. **Në deklaratën e Kontrollit të Figurës shtojca 1 subjekti ka deklaruar se:**

Gjeneralitetet

- Nuk ka ndryshim të gjeneraliteteve.
- Se nuk është njohur nga të tjerë me ndonjë nofkë, emër apo mbiemër tjetër,
- Se nuk ka pasur nënshtetësi tjetër,

Në deklaratën për kontrollin e figurës, pjesa e 2-të, shtojca 1, subjekti deklaron të dhënat përkatëse mbi vendbanimin,

Në pjesën 3 dhe 4, të shtojcës 1, subjekti ka deklaruar të dhëna ndër vite lidhur me arsimin, kualifikimet, specializimet apo trajnimet dhe punësimin përkatës,

Në pjesën 5, të shtojcës 1, lidhur me të dhënat e sigurisë subjekti ka deklaruar:

- Nuk është dënua ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj,
- Nuk ka qenë në hetim dhe gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligj zbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk ka qenë caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo.
- Nuk është lëshuar asnjëherë ndaj tij një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk është marrë asnjëherë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- Nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët, bashkëjetuesi/t si dhe personat e përfshirë në certifikatën familjare) është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së subjektit.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
- Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit sipas përcaktimeve të ligjit për integritetin e personave që zgjidhen emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- Nuk ka fshehur apo keq prezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe të një natyre sigurie të veçantë apo gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- Nuk ka kryer shkelje sigurie apo të ketë nëpërkëmbur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka qenë asnjëherë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1991, sipas ligjit “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish- shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
- Nuk ka vuajtur nga çrregullime mendore kronike.
- Nuk është përdorues i lëndëve narkotike
- Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit.
- Po ashtu, subjekti ka nënshkruar edhe dy vetëdeklarimet për vërtetësinë e të dhënave dhe saktësinë e tyre të paraqitura në deklaratën e kontrollit të figurës si dhe deklaratën për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale.

#### ❖ **Hetimi i kryer nga Trupa Vlerësuese e AMP:**

74. Për të vijuar me kontrollin tërësor të figurës dhe saktësinë e deklaramit të subjektin e vlerësimit lidhur me këtë aspekt, në bazë të nenit 36, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, “Për vlerësimin

kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, janë kryer veprimet e duhura nga struktura përgjegjëse pranë AMP duke kërkuar të dhëna nga institucionet të shprehura në këtë ligj.

75. Në bazë të informacionit të dërguar nga institucionet përgjegjëse, Trupa e vlerësimit konstatoi se:

- **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile** me shkresën “I kufizuar” nr. \*\*\* prot, datë 15.08.2023 konfirmon se: *Nuk ka ndryshim të gjeneraliteteve të subjektit të vlerësimit Z. Niko Axhem Brahimaj.*
- o **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve** me shkresën “I kufizuar” nr. \*\*\* prot, datë 28.07.2023 konfirmon se : *Nuk rezulton i dënuar.*
- o **Organi ligjzbatues** me shkresën “Sekret” nr. \*\*\* prot, datë 09.08.2023 bën me dije se: *Disponohen të dhëna mbi të cilat ka informuar Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit në vitin 2020 dhe 2021 përkatësisht me shkresat nr. \*\*\*, datë 14.04.2020 dhe nr. \*\*\*, datë 05.01.2021 respektivisht në përgjigje të shkresave nga KJV nr.\*\*\*, datë 25.11.2019 dhe nr.\*\*\*, datë 30.10.2020, në zbatim të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar.*

Të dhënat në ngarkim të subjektit të vlerësimit janë ndarë me institucionet e tjera ligjzbatuese të cilat kanë kryer verifikimet përkatëse ku ka rezultuar se:

  - Nuk janë vërtetuar e dokumentuar dhe nuk janë në kuadër të dyshimeve të arsyeshme.
  - Nuk ka fakte apo prova që subjekti është i përfshirë apo i dyshuar në përfshirje në krimin e organizuar, apo që tregojnë që ka kontakte të pa përshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.
  - Nuk rezulton që në emër të subjektit të vlerësimit të jetë regjistruar procedim penal.
- o **Organi ligjzbatues** me shkresën “I kufizuar” nr. \*\*\* prot, datë 11.08.2023 konfirmon se:
  - a) *Nuk ka dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cenimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta.*
  - b) *Nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, (sipas përcaktimeve të bëra në ligjin Nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"), ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike, etj.;*
  - c) *Nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të Ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar;*
  - d) *Nuk ka të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një vepre penale;*
  - e) *Nuk ka të dhëna në lidhje nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale;*
  - f) *Nuk ka të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhëri ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale;*
  - g) *Nuk ka të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj;*
  - h) *Nuk ka të dhëna në lidhje nëse gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATOS-S;*



- i) *Nuk ka të dhëna nëse nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet.*
- j) *Nuk ka procedim disiplinor apo masë disiplinore.*
- **Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes** me shkresën “Konfidencial” nr. \*\*\* prot, datë 04.08.2023 konfirmon se: *Nuk disponon të dhëna.*
  - o **Nga një institucion tjetër ligjzbatues** me shkresën “Sekret” datë 03.08.2023 dhe shkresën “Sekret” nr. \*\*\* prot, datë 03.10.2023 dhe shkresës “I Kufizuar” nr.\*\*\* datë 16.08.2023 konfirmon se:
    - o *Nuk ka të dhëna për përfshirje në aktivitet të kundërligjshëm.*
    - o *Nuk ka procedime penale të referuara.*
    - o *Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka regjistruar procedimin penal nr.\*\*\*/2003, të iniciuar me kallëzimin penal të shtetasit A.S në të cilën kërkohet ndjekja penale ndaj Komisar Niko Brahimaj dhe D. Xh. për veprën penale “Kryerjen e veprimeve arbitrare” parashikuar nga neni 250, i K.P. për ushtrim dhunë fizike ndaj tij. Në përfundim të hetimeve, prokurori i çështjes me datë 05.06.2003 ka vendosur pushimin e çështjes.*
    - o *Në lidhje me këtë fakt Trupa Vlerësuese ju drejtua subjektit të vlerësimit me pyetësorin e datës 19.04.2024 ku u pyet nëse “nëse keni patur dijeni për këtë procedim penal?”. Në kthim përgjigjen e tij të datës 23.04.2024 subjekti sqaron se: “Nuk kam patur dijeni se ndaj meje ka filluar një procedim penal. Kam dhënë një deklaram në cilësinë e personit që ka dijeni, po jo ndaj të cilit zhvillohen hetime.”*
    - o *Për subjektin e vlerësimit disponohen ankesa/problematika, të dhëna ose informacione që lidhen me objektin e kërkesës.*
    - o *Nga verifikimi, trajtimi i ankesave ose inspektimit për subjektin e vlerësimit është sugjeruar fillimi i hetimit penal ose disiplinor dhe përfundimi i tyre.*  
*Në bazë të dhënave që administrohen nga Drejtoria e Inspektimit dhe Ankesave, në Drejtorinë e Përgjithshme të AMP-së, e cila bën me dije se për subjektin e vlerësimit Niko Axhem Brahimaj, në Sistemin e Menaxhimit të Ankesave është regjistruar Raportimi i Komisarariatit Dixhital, nr.12 \*\*\*, regjistruar me numër unik 011\*\*\*.*  
*Denoncimi është trajtuar nga Drejtoria Rajonale e AMP-së Shkodër-Lezhë dhe ka rezultuar se informacioni është i pa bazuar në prova dhe fakte.*
  - **Organi ligjzbatues** me shkresën “I kufizuar” nr. \*\*\* prot, datë 27.09.2023, si edhe me shkresën “I kufizuar” nr. \*\*\* datë 29.05.2024 konfirmon se:
    - o *Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi.*
    - o *Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal.*
    - o *Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;*
    - o *Ka pasur regjistrim të njoftimit të veprave penale.*
  - **Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë**, të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, me shkresën e "Paklasifikuar", Nr.\*\*\* Prot., datë 08.08.2023, bën me dije se:
    - o *Drejtoria e Koordinimit Institucional në Prokurorinë e Përgjithshme konfirmon se: nga verifikimi i bërë nga zyra e regjistrat dhe zyra e arkivës (regjistrat fizikë dhe elektronik), në Prokurorinë Elbasan, është regjistruar procedimi penal Nr. \*\*\*, datë 08.04.2003, me persona nën hetim shtetasit, Niko Brahimaj dhe D. Xh., mbi bazën e kallëzimit të dhënë nga shtetasi A.S, për veprën penale të parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal. Më datë 05.06.2003, prokurori i çështjes ka vendosur pushimin e procedimit penal Nr. \*\*\*/2003. Bashkëlidhur kësaj shkrese po ju dërgojmë një kopje të vendimit të pushimit.*

- **Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë**, të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër me shkresën “Sekret” nr.\*\*\* prot., datë 03.05.2024, bën me dije se:
    - o *Nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.05.2021, ka ardhur për kompetencë kallëzimi penal i P.D., në ngarkim të shtetasit Niko Brahimaj etj., për veprat penale të parashikuara nga nenet 248, 278, 328, 333/a të Kodit Penal. Në lidhje me këtë kallëzim penal, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit Shkodër është regjistruar kallëzimi penal nr. \*\*\* datë 12.05.2021, për të cilin është marrë vendim për mosfillimin e procedimit penal, më datë 24.05.2021*
    - o *Nuk ka pasur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.*
  - **Nga një institucion tjetër ligjzbatues** me shkresën “I kufizuar” nr. \*\*\* prot, datë 11.08.2023 bën me dije se:
    - o *Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi.*
    - o *Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal.*
    - o *Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të kodit të Procedurës Penale.*
    - o *Nuk ka pasur regjistrim të njoftimit të veprave penale.*
    - o *Nuk ka pasur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.*
  - **Nga një institucion tjetër ligjzbatues** me shkresën “Sekret” nr. \*\*\* prot, datë 04.08.2023 konfirmon se:
    - o *Nuk rezulton raportime për subjektin e vlerësimit z. Niko Brahimaj dhe personat e tjerë të lidhur me të, përveç atyre rutinë.*
  - **Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar** me shkresën “I kufizuar, nr. \*\*\* prot, datë 31.07.2023 konfirmon se :
    - o *Nuk është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP) të vlefshme.*
    - o *Nga AKSIK nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP.*
    - o *AKSIK nuk disponon rekorde sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror, të NATO, BE, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.*
  - **Avokati i Popullit** me shkresën “E paklasifikuar” nr.\*\*\* prot, datë 14.08.2023 konfirmon se:
    - o *Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime ose mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.*
    - o *Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.*
  - **Një institucion ligjzbatues** me shkresën “I kufizuar” nr. \*\*\* datë 07.05.2024 konfirmon se:
    - o *Nuk rezulton që në emër të shtetasve të mëposhtëm të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.*
  - **Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit** me shkresën “I kufizuar” nr.\*\*\* datë 24.11.2023 bën me dije se:
    - o *Nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i shtetit deri me 02 Korrik1991.*
76. Pranë Trupës Vlerësuese, nuk janë paraqitur denoncime nga publiku ndaj subjektit të vlerësimit Niko Brahimaj, për shkelje të rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, sipas parashikimit ligjor të nenin 36 pika “ë” të ligjit nr.12/2018 (i ndryshuar).
77. Testi për përdorim lëndësh narkotike:  
 Subjekti i vlerësimit z. Niko Brahimaj në zbatim të pikës 2, të nenit 38, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.03.2024 të Institutit Mjekësisë Ligjore protokolluar me tonën nr.\*\*\* datë 02.04.2024 ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara të testimit për përdorim lëndësh narkotike, konkludohet se:

- Në mostrën e urinës marrë subjektit me kod shifror \*\*\*, mbyllur në kontejner, nuk u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të MOP (opiate/heroine), COC (cocaine), MTD (metadon), THC (canabinoide/cannabis sativa), BARB (barbiturate), TCA (tricklike antidepressante), AMP (amfetamine), MDMA. MET (metamfetamina), BZO (benzodiazepina).

#### 78. Në përfundim të hetimit të kryer:

Trupa e Vlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit, analizimit dhe verifikimit të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese, si dhe raportin e sjellë nga struktura përgjegjëse e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit Z. Niko Brahimaj:

- ✓ *Ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;*
- ✓ *Nuk ka informacion në deklarimin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.*

### C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

79. Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar dhe në legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të “Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.

80. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;
- Raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore/standartet profesionale në Policinë e Shtetit/Gardën e Republikës/Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar. Subjekti i vlerësimit Z. Niko Brahimaj në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin “Drejtor i Institutit të Policisë Shkencore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.”.

81. Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të vlerësimit mbështetet në informacionin dhe dokumentacionin e marrë nga DPPSH, në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i vlerësimit gjatë hetimit administrativ kryesisht si dhe nga burime të tjera të ligjshme për nivelin e arsimimit në përputhje me pozicionin e punës. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e vlerësimit, është kryer në përputhje me kreun V, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të Ligjit nr. 12/2018, (i ndryshuar), bazuar në nenet 43 - 46 të po këtij ligji.

82. Vlerësimi i Aftësive Profesionale nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për subjektin e vlerësimit Z. Niko Brahimaj, bazuar në nenin 47, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar

me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.08.2023 protokolluar me tonën nr. \*\*\*prot., datë 14.08.2023 arrin në përfundim se:

- *Punonjësi i policisë Z. Niko Axhem Brahimaj është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të detyrave sipas përshkrimeve të punës, ka respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme duke rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar funksionin që mban.*
83. Niko Brahimaj është subjekt i vlerësimit të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar dhe aktualisht mban detyrën Drejtor i Institutit të Policisë Shkencore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.”, bazuar në Urdhërin e emërimit, Nr. \*\*\*, datë 05.07.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
84. Objekti i vlerësimit të aftësive profesionale sipas përcaktimit të nenit 43, të këtij ligji, ka të bëjë me vlerësimin e nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin, respektimin e rregullave të etikës, si dhe përmbushjes së detyrave nga subjekti në përputhje me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e Policisë së Shtetit.
85. Procedura për vlerësimin e aftësive profesionale kryhet bazuar në nenet 44 - 46, duke mbajtur në vëmendje aftësitë profesionale dhe ecurinë në karrierë të punonjësit duke respektuar legjislacionin e posaçëm që rregullon marrëdhënien e punës (në këtë rast Ligji për Policinë e Shtetit, Rregullorja e Policisë dhe aktet e tjera rregullatorë e nënligjore në fuqi) si dhe në përshkrimet e punës për çdo funksion.
86. Trupa Vlerësuese përdor si burime për vlerësimin e saj, fillimisht:
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e Aftësive Profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar;
  - Më tej të dhënat nga institucionet përgjegjëse që konfirmojnë nivelin arsimor dhe kualifikimet përkatëse, ecurinë në karrierë të subjektit nga dosja e personelit, vërtetime e akte të tjera administrative të emërimeve në funksione dhe dhënies së gradave respektive, ecurinë disiplinore, vendimet e formës së prerë të gjykatave që lidhen me procese disiplinore etj. Vlerësimet e punës individuale në pesë vitet e fundit. Gjithashtu, Trupa e Vlerësimit mban në konsideratë dhe shqyrton edhe denoncimet nga publiku për sjellje jo profesionale të punonjësit, apo informacione të tjera të lidhura me ushtrimin e detyrës së tij në mënyrë jo etike.
  - Afati kohor brenda të cilit shtrihet procesi i vlerësimit të aftësive profesionale:
87. Subjekti i vlerësimit Niko Brahimaj ka dorëzuar në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, (Formularin e Vetëvlerësimit të Aftësive Profesionale), sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të Ligjit Nr. 12/2018, të ndryshuar. Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 vjet.
88. Subjekti në kohën e depozitimit të formularit, mbante detyrën e Drejtor i Institutit të Policisë Shkencore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, funksion që e mban që prej datës 05.07.2021.

## VLERËSIMI I NIVELIT ARSIMOR

89. Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimit dhe përshtatshmëria me kriteret e pozicionit të punë, sipas parashikimit të nenit 45, pika 2/a, e ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar. Sipas të dhënave të administruara në Dosjen Personale të Subjektit, rezulton së subjekti ka përfunduar arsimin e lartë.
90. Në formularin e Aftësive Profesionale për Vlerësimin Kalimtar subjekti ka deklaruar:
- ✓ Diplomë, Shkolla e Lartë e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Viti i fillimit 1987, përfunduar më 1991. Diplomuar në Degën “Sigurim”. Nr. i Regjistrimit:\*\*\* datë 25.06.1991.
  - Të dhënat janë të administruara në dosjen personale të subjektit të vlerësimit me nr. \*\*\*.
  - Të dhënat e administruara në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Sistemi RMIS me numër RMIS \*\*\*
  - Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në Formularin e Aftësive Profesionale për Vlerësimin Kalimtar.
  - Të dhënat e siguruar nga Drejtoria e Standardeve Profesionale mbi Performancën e Subjektit.
  - Të dhënat e siguruar nga burimet e mësipërme, konfirmojnë nivelin arsimor, ecurinë në karrierë dhe gradë, trajnimet, kualifikimet dhe vlerësimet individuale të punës si edhe performancën e konstatuar gjatë kontrolleve dhe inspektimeve apo ankesave në drejtim të subjektit nga Drejtoria e Standardeve Profesionale apo institucionet e tjera mbikëqyrëse.
- Në kuptim të ligjit Nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar punonjësi/subjekti rezulton së subjekti, përmbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që ushtron pranë Policisë së Shtetit në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale.

### ❖ Arsyetimi ligjor i Trupës Vlerësuese:

91. Në kuptim të legjislacionit për Policinë e Shtetit dhe në ligjin në fuqi Nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, trupa e vlerësimit arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, që në kohën e emërimit në detyrë për herë të parë në Policinë e Shtetit dhe deri në vijueshmërinë e ecurisë në karrierë të tij, ka qenë në përmbushje të kriterit të nivelit arsimor.
92. Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale të subjektit, rezulton së ai ka kryer trajnimet/specializimet si vijojnë:

Nr.	Viti	Emërtimi i trajnimit	Dokumenti
1.	2000	Trafikim i mjeteve motorike, Gjermani	Certifikatë
2.	2000	Antiterrorizëm, Washington	Certifikatë
3.	2000	Menaxhim i forcave speciale, New Mexico	Certifikatë
4.	1999	Menaxhim i nivelit të lartë policor. MPB	Certifikatë

## VLERËSIMET E PUNËS:

93. Në dosjen personale të subjektit, për periudhën 2018 - 2023 rezulton së janë të administruara 5 (pesë) vlerësime të aftësive individuale të punës, në të cilat është vlerësuar si vijon:

- Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2018 28 Pikë (shumë mirë)
- Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2019 28 Pikë (shumë mirë)
- Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020 28 Pikë (shumë mirë)
- Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021 28 Pikë (shumë mirë)
- Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2022 98 Pikë (shumë mirë)

Vlerësimi i aftësive individuale të punës sipas standardeve të përcaktuara bëhet nga eprori i drejtpërdrejtë, bazuar në vlerësimin e integritetit, profesionalizmit, komunikimit, qëndrimit konstruktiv, paanshmërisë, punës në grup si dhe planifikimit dhe organizimit të punës.

### ❖ Konkluzion i Trupës Vlerësuese:

94. Bazuar në vlerësimet e mësipërme të punës Trupa Vlerësuese arrin në konkluzion se subjekti i vlerësimit ka përmbushur detyrat funksionale, respektuar rregullat e etikës si edhe ka shfaqur performancë të lartë në kryerjen e detyrave funksionale.

95. Nga verifikimi në dosjen personale si dhe sistemin RMIS, rezulton së gjatë periudhës 5 vjeçare, (2018-2023) të përcaktuar në pikën 2, të nenit 44, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit, nuk është ndëshkuar disiplinarisht me masë disiplinore. Për sa analizuam rezulton se deklarimi i subjekti është i saktë.

### ❖ ECURIA NË KARRIERË:

96. Subjekti Niko Axhem Brahimaj ka një karrierë në Policinë e Shtetit prej 19 vitesh e 9 muaj. Nga verifikimi në dosjen personale rezulton se gjatë periudhës 5 vjeçare objekt deklarimi, subjekti Niko Axhem Brahimaj, ka ecurinë në karriere si vijon:

- ✓ 01.05.2018 deri më 29.03.2019 Drejtor, në Drejtorinë Kundër krimeve ndaj personit,
- ✓ 30.03.2019 deri më 05.07.2021 Drejtor, në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër,
- ✓ 06.07.2021 e në vazhdim Drejtor, në Institutin e Policisë Shkencore.

### 97. ECURIA NË GRADË:

- a. Me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr. \*\*\*, datë 09.10.2013 “Për Ripranimin në strukturat e policisë së shtetit dhe caktimin në detyrë të z. Niko Brahimaj” bazuar në nenin 58, të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007, “Për Policinë e Shtetit”, në nenin 44, nenin 45 dhe nenin 62, pika 2, shkronja “b” e rregullores së Personelit të Policisë së Shtetit” si edhe në Vendimin e Komisionit të Verifikimit nr. \*\*\* datë 09.10.2013, z. Niko Brahimaj, ish punonjës policie, liruar nga policia me motivacionin “Me kërkesë të tij”, të ripranohet në strukturat e policisë dhe ti jepet grada policore “Drejtues”.
- b. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. \*\*\*, datë 02.06.2014 “Për dhënien e gradës policore një punonjësi policie”, bazuar në nenin 20, pika 2 nenin 58, pika 2, e ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” me procedurën standarde “Ricertifikim i punonjësve që ripranohen në polici” miratuar me urdhër të Drejtorit të

Përgjithshëm të Policisë, në Vendimin nr. \*\*\*, datë 27.05.2014 të Komisionit të Vlerësimit për gradë policore të nivelit të mesëm drejtues, Drejtues Niko Brahimaj, ricertifikuar për gradën “Drejtues i Parë”, i jepet grada “Drejtues i Parë”.

### **HETIMI I KRYER NGA TRUPA VLERËSUESE:**

98. Pas shqyrtimit të dokumentacioni në dosjen e subjektit të vlerësimit , në lidhje me ecurinë në gradë dhe në karrierë të Z. Niko Axhem Brahimaj konstatojmë se, me urdhër të Ministrit të Brendshëm, nr.\*\*\*, datë 21.03.2006, z. Niko Brahimaj është larguar nga strukturat e policisë së shtetit dhe në momentin e largimit nga Policia e Shtetit subjekti ka mbajtur gradën policore “Komisar”.
99. Me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr. \*\*\*, datë 09.10.2013 “Për Ripranimin në strukturat e policisë së shtetit dhe caktimin në detyrë të z. Niko Brahimaj” bazuar në nenin 58, të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007, “Për Policinë ë Shtetit”, i jepet grada policore “Drejtues”.
100. Trupa konstaton se bazuar në nenin 58, pika 2, e Ligjit nr. 9749 datë 04.06.2007, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar subjekti i vlerësimit, i cili nga momenti i ripranimit kanë kaluar mbi 12 muaj nga data e largimit, vazhdon karrierën e tij me gradën policore “Drejtues”, (sipas sistemit të ri të gradave).
101. Me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr. \*\*\*, datë 02.06.2014 “Për dhënien e gradës policore një punonjësi policie” bazuar në nenin 20 pika 2, nenin 58, të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007, “Për Policinë ë Shtetit”, Drejtues Niko Brahimaj ricertifikuar për gradën “ Drejtues i Parë” i jepet grada policore “Drejtues i Parë”.
- ✓ Trupa Vlerësuese vlerëson se, marrja e gradës “Drejtues”, dhe “Drejtues i Parë” është dhënë në përputhje me ligjin.
102. Në përfundim të hetimit të kryer, Trupa e Vlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar, nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit si dhe verifikimin mbi përmbushjen e detyrave funksionale, arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit Z. Niko Brahimaj:
- ✓ *Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;*
  - ✓ *Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban;*
  - ✓ *Ka vlerësime pozitive pune.*

### **KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR**

Trupa e Vlerësimit e AMP, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike datë 09.09.2024, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti i vlerësimit z. Niko Brahimaj në përputhje me nenin 60, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- **Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë,**
- **Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës,**
- **Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.**

**PËR KËTO ARSYE:**

Trupa e Vlerësimit e AMP, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në bazë të germës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar:

**V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit, Z. **Niko Axhem Brahimaj**, me funksion, **Drejtor i Institutit të Policisë Shkencore.**
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve, nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në **Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.**

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë **09.10.2024.**

**TRUPA E VLERËSIMIT**

**Kryesuese**

**Suela BULKU**

**Relator**  
**Arben SEFAJ**

**Anëtare**  
**Denisa SINA**